

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5896
E shtunë, 5 tetor 2019
çmimi 0.40 €

Richard Grenell, i dërguar i ShBA-së për dialogun Kosovë - Serbi

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FILLON HESHTJA ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË 6 TETORIT ■ FAQE 6-7

NESËR VENDOS SOVRANI



Subjektet politike kanë përfunduar fushatën zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit me tubime madhështore në Prishtinë, Gjilan, Gjakovë dhe Prizren. Kandidatët për

kryeministër, në ditën e dhjetë të fushatës, kanë bërë përpjekjen e fundit me premtimet e tyre për t'i bindur qytetarët që t'i votojnë. Në anën tjetër, KQZ-ja, policia, organet e drejtësisë dhe Demokracia në

Veprim kanë bërë me dije se janë bërë të gjitha përgatitjet për procesin zgjedhor. Të dielën do të garojnë 25 subjekte politike dhe të drejtë vote do të kenë 1 937 869 qytetarë të Republikës së Kosovës

OPINION

FITUESI I ZGJEDHJEVE TË 6 TETORIT DO TË JETË HUMBËSI MË I MADH F. 12

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE



LOBI I GRAVE TË RAJONIT: QYTETARËT TË VOTOJNË PËR PROGRAMET DHE PËR MË SHUMË GRA F. 7

HAPET ÇERDHJA "KETRUSHËT" NË LAGJEN TOPHANE TË PRISHTINËS F. 11

EKONOMI



SHIFK NIS BASHKËPUNIMIN ME ODËN EKONOMIKE TË KOSOVËS F. 9

SPORT

MORINA: FERONIKELI VJET DHE SIVJET F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", ARTAN MURATI ■ FAQE 4-5

Zgjedhjet e 6 tetorit, të paparashikueshme

Njohësi i proceseve politike dhe zgjedhore, njëherësh menaxher i projektit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) për monitorimin e Kuvendit të Kosovës, Artan Murati, ka thënë se në fushatë ka pasur garë më të gjerë mes kandidatëve për kryeministër dhe partitë politike janë treguar më të disiplinuar për respektimin e kodit të mirësjelljes. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se zgjedhjet e 6 tetorit do të jenë të paparashikueshme dhe shumë të ngushta në mes të subjekteve kryesore politike. Murati ka theksuar se këto zgjedhje duhet të prodhojnë institucione të besueshme dhe të afta për të punuar për të mirën e qytetarëve



ASK-ja: Në vitin 2018 mbi 13 000 persona u punësuan në shëndetësi

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com


Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Holanda: Shqipërisë nuk i hapim negociatat, Maqedonisë së Veriut po



TIRANË, 4 TETOR - Holanda është e bindur se Bashkimi Evropian nuk duhet t'i fillojë negociatat e pranimit me Shqipërinë. Pas mbledhjes së Qeverisë së Holandës të premtën, ministri i Punëve të Jashtme, Stef Blok u shpreh për mediet se Shqipëria nuk është ende gati për t'i nisur bisedimet. "Shqipëria duhet të ndërmarrë hapa të mëtejshëm, veçanërisht në luftën ndaj korrupsionit dhe përmirësimin e sundimit të ligjit", tha Blok pas mbledhjes

së Këshillit të Ministrave. Në muajin qershor Parlamenti i Holandës votoi një mocion ku pozicionohej kundër bisedimeve të pranimit me Shqipërinë. Ndërkohë, ministri i Jashtëm i Holandës tha se për Maqedoninë Veriore ruga duket e qartë për t'i filluar bisedimet me BE-në për anëtarësimin. "Maqedonia Veriore ka ndërmarrë hapa të mëdhenj përpara. Përparimi në sundimin e ligjit

duhet të vazhdojë, kështu që ne shohim përmirësim të mëdha atje, tha ministri Blok. Ministrat e jashtëm të BE-s do të diskutojnë çështjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut brenda një jave e gjysmë. Më pas, nëse ministrat do bien dakord, çështja e Shqipërisë dhe Maqedonisë do të kalohet për vendimin final në tavolinën e krerëve të qeverive të Bashkimit Evropian.

Pompeo tërheq vëmendjen për ndikim rus në Maqedoninë Veriore

Sekretari amerikan i Shtetit tha se Uashingtoni mbështet institucionet në procesin e anëtarësimit në NATO dhe për integrimin në BE dhe se zemra dhe mendja e qytetarëve të Maqedonisë duhet ta udhëheqin shtetin e jo ndikimet ruse në rrjetet sociale



SHKUP, 4 TETOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, pas takimeve në Ohër me drejtuesit shtetërorë të Maqedonisë së Veriut, ka riafirmuar mbështetjen e fuqishme amerikane për paqen, stabilitetin dhe sigurinë, jo vetëm të këtij vendi, por edhe të rajonit në përgjithësi.

Pas takimit me presidentin Stevo Pendarovski dhe kryeministrin Zoran Zaev, Sekretari amerikan i Shtetit tha se Uashingtoni mbështet institucionet në procesin e anëtarësimit në NATO dhe për integrimin në BE. Pompeo tha se "zemra dhe mendja e qytetarëve të Maqedonisë duhet ta udhëheqin shtetin e jo ndikimet ruse në rrjetet sociale".

"Demokracitë duhet të thirren në brengat e qytetarëve dhe të luftojnë kundër ndikimeve të këqija. Zemra dhe mendja e qytetarëve të Maqedonisë së

Veriut duhet ta udhëheqin shtetin para dhe jo ndikimet ruse në rrjetet sociale dhe do të doja t'ua tërheq vëmendjen edhe për pjesëmarrjen e Kinës në fushën e teknologjive të ndjeshme", tha ai, ka njoftuar rfe.

"Presidenti Trump në Kombet e Bashkuara tha se e ardhmja u takon shteteve sovraane dhe të pavarura që i mbrojnë qytetarët e saj dhe t'i respektojnë fqinjët. Maqedonia e Veriut reflekton këtë frymë. ShBA-ja do të vazhdojë të jetë partner me ju për të mirën e qytetarëve tuaj, për rajonin dhe botën", ka thënë Pompeo, duke theksuar rëndësinë që ka për të ardhmen e vendit edhe lufta kundër krimit të organizuar dhe dukurive tjera negative.

"Të gjithë ata që e kanë keqpërdorur besimin e marrë, duhet të japin llogari. Si demokraci udhëheqëse bë botë, SHBA-ja

mbështet shtetet që luftojnë për sundimin e së drejtës. Lufta kundër korrupsionit është shumë e rëndësishme për integrimin e vendit në BE dhe në NATO", është shprehur Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo.

Ai ka vlerësuar lart marrëveshjet që ka arritur Maqedonia e Veriut me Greqinë dhe Bullgarinë që i hapën rrugën integritimit euroatlantik të vendit.

"Jam i bindur se Maqedonia e

Veriut do të jetë një aleat i fuqishëm në NATO dhe jam i bindur se Senati i ShBA-së këtë vjeshtë do të miratojë protokollin për anëtarësim, me çka edhe formalisht do t'ju dëshirojmë mirëseardhjen në Aleancë", ka theksuar Pompeo.

Nga ana tjetër, kryeministri Zoran Zaev ka thënë se mbështetja amerikane për Maqedoninë e Veriut është shumë e rëndësishme për sigurinë, stabilitetin dhe të ardhmen

e saj. "Ne jemi të gatshëm që me ritëm edhe më të fuqishëm të marrim pjesë në të gjitha nismat globale që konfrontohen me dezinformatat dhe kërcënimet për demokracinë. Me anëtarësimin tonë në NATO kontributi ynë në këtë sferë do të paraqesë nxitje edhe më të madhe dhe dimension të ri. Anëtarësimi në NATO është vendim sovran yni që ka mbështetje të madhe politike dhe konsensus ndëretnik. Me këtë ne arrijmë qëllimin tonë historik", ka deklaruar Zaevi.

Ai ka thënë se Maqedonia e Veriut është shtet unik në rajon pasi nuk ka asnjë kontest me shtetet fqinjët duke përmendur këtu arritjen e marrëveshjeve me Greqinë dhe Bullgarinë që i kanë hapur rrugën integritimit të vendit në NATO dhe BE.

Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, edhe në takimin me presidentin Stevo Pendarovski ka theksuar mbështetjen amerikane jo vetëm për Maqedoninë e Veriut, por edhe për rajonin në përgjithësi. Vizita e Sekretarit amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, është e para e një niveli kaq të lartë që nga vizita e ish-sekretarit, Colin Powell, 19 vjet më parë.

Majko sulmon Ramën: Ideja e ndarjes së kufijve erdhi nga Beogradi

TIRANË, 4 TETOR - Pandeli Majko, ish-kryeministër i Shqipërisë gjatë luftës së Kosovës, deklaroi të premtën se ideja e ndarjes së territorit të Kosovës me Serbisë ishte shqetësuese për Tiranën. Ai tha se kjo ide nuk erdhi nga Prishtina, por nga Beogradi. "Nuk më pëlqen që nga Tirana të dalin kompetentë për çfarë ndodh në Prishtinë. Dhe nuk më pëlqen që nga Prishtina të dalin disa kompetentë që të flasin me kompetencë të plotë se çfarë ndodh në Tiranë.

Mendoj se jemi ende herët që të flasim me kompetencë se çfarë po ndodh në Prishtinë. Kjo historia e "kompetentëve" duhet parë me shumë kujdes. Mendoj që kjo më shumë mund të prishë punë sesa të rregullojë punë. Sa i përket çështjes së kufirit ishte një çështje që shqetësoi të gjithë klasën politike, por jo vetëm Prishtinën dhe Tiranën, por edhe më gjerë. Mendoj se ishte një mënyrë që nuk vinte nga Prishtina, por nga Beogradi zyrtar. Kur të

gjithë në Bruksel dhe në qendrat e rëndësishme të Evropës e shohin Beogradin me kujdes, kjo nuk orientohet nga pesha e vërtetë gjeopolitike që ka Beogradi, por pas Beogradit qëndron "Ariu i madh", u shpreh Majko.

Qëndrimi i Majkos kundër ndarjes së Kosovës kritikoi direkt qëndrimet e kryeministrit Edi Rama. Kreu i qeverisë ka qenë një nga mbështetësit e kësaj ideje së bashku me presidentin e Kosovës Hashim Thaçi



dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Edhe më serioze për pozicionin e Ramës

në këtë histori është deklarata e Majkos se pas Beogradit qëndron "Ariu i madh", pra Rusia.

Richard Grenell, i dërguar i ShBA-së për dialogun Kosovë - Serbi



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Gjermani do të jetë përfaqësues i presidentit amerikan Donald Trump për bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Shtëpia e Bardhë ka njoftuar të premten se ambasadori Grenell do t'i udhëheqë përpjekjet e ShBA-së për t'iu ndihmuar Kosovës dhe Serbisë për arritjen e një marrëveshjeje zyrtare të paqes e cila do të mund të rezultojë me njohjen e Kosovës nga Serbia. Emërimi i tij është mirëpritur nga liderët shtetërorë të Kosovës të cilët kanë shprehur përkushtimin për të punuar së bashku në këtë proces

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 4 TETOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara (ShBA), Donald Trump, ka zgjedhur ambasadorin amerikan në Gjermani, Richard Grenell, të dërguar të administratës së tij në dialogun midis Kosovës dhe Serbisë. Shtëpia e Bardhë të premten ka njoftuar Grenellin, i cili do të mbetet edhe ambasador në Gjermani, do t'i udhëheqë përpjekjet e ShBA-së, për t'iu ndihmuar Kosovës dhe Serbisë për arritjen e një marrëveshjeje zyrtare të paqes, e cila do të mund të rezultojë me njohjen e Kosovës nga ana e Serbisë.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka mirëpritur vendimin e presidentit amerikan, duke thënë se do të bashkëpunojë me Grenellin për ta siguruar arritjen përfundimtare të paqes në Ballkan. Me këtë rast, Thaçi ka realizuar të premten një bisedë telefonike me ambasadorin Richard Grenell të cilit i ka thënë se mirëpret rolin e shtuar të

Shteteve të Bashkuara të Amerikës në procesin e dialogut. Sipas Thaçit, ky është konfirmim i përkushtimit personal të presidentit Trump që të arrihet një marrëveshje e paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Emërimi juaj shton konfidencën dhe besimin tonë në këtë proces dhe në mundësinë për të arritur një marrëveshje të paqes përfundimtare me Serbinë. Ky është konfirmim i përkushtimit personal të presidentit Trump që të arrihet një

marrëveshje e paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë", është shprehur presidenti Thaçi në këtë bisedë telefonike.

Edhe kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, ka mirëpritur emërimin e ambasadorit Grenell si i dërguar i ShBA-së për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke thënë se do të punojnë bashkë për arritjen e njohjes reciproke në kufijtë ekzistues. "Mirëpres emërimin nga presidenti Trump të



ambasadorit aktual të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Gjermani, z. Richard Grenell, si i dërguar i posaçëm për dialogun Kosovë - Serbi. Do të punojmë dhe angazhohemi bashkë rreth dialogut pa kushte, për arritjen e njohjes reciproke në kufijtë ekzistues", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Ndërsa ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë se emërimi i Richard Grenellit tregon përkushtimin e qeverisë amerikane për një përparim të shpejtë drejt një të ardhme paqësore për rajonin. "Mezi presim të punojmë me ambasadorin Ric Grenell si të dërguarin e posaçëm të presidentit për negociatat e paqes në Serbi dhe Kosovë. Emërimi i tij, krahas Matt Palmerit (i dërguar i Departamentit të Shtetit për Ballkanin Perëndimor), tregon përkushtimin e qeverisë amerikane për përparim të shpejtë drejt një të ardhme paqësore për rajonin", ka shkruar Kosnett në rrjetin social "Twitter".

Kurse zëdhënësja e Bashkimit Evropian (BE), Maja Kocijançiq, ka thënë se BE-ja po punon ngushtë me Shtetet e Bashkuara për Ballkanin Perëndimor. "ShBA-ja ka dhënë kontribut të çmuar në punën tonë në Ballkanin Perëndimor, në veçanti për suksesin e dialogut (Kosovë-Serbi). ShBA-ja dhe BE-ja ndajnë interesin e fuqishëm për një Ballkan Perëndimor stabil dhe të

përparuar", ka thënë Kocijançiq, duke konfirmuar gatishmërinë e BE-së për vazhdimin e bashkëpunimit të ngushtë me ShBA-në. Kjo deklaratë ka ardhur pas emërimit të ambasadorit Grenell në postin e të dërguarit të ShBA-së për dialogun Kosovë - Serbi.

Richard Grenell nga Kalifornia do të shërbejë njëkohësisht si i dërguar special presidencial për negociatat paqësore të Serbisë dhe Kosovës dhe si ambasador i jashtëzakonshëm dhe i plotfuqishëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën Federale të Gjermanisë.

Grenell ka shërbyer si ambasador i ShBA-së në Gjermani që nga 8 maji i vitit 2018. Grenell është shkrimtar dhe komentues i politikës së jashtme dhe ka themeluar firmën ndërkombëtare konsultuese Capitol Media Partners në vitin 2010.

Për gati dy dekada ai ka shërbyer këshilltar kryesor për komunikime për zyrtarët publikë në nivelin federal, shtetëror, lokal dhe ndërkombëtar, si dhe për kompanitë e ranguar në Fortune 200. Grenell është personi që ka shërbyer më së gjati si zëdhënës i Shteteve të Bashkuara në Kombet e Bashkuara (2001-2008) dhe gjatë kësaj kohe ai ka punuar për katër ambasadorë. Ai ka diplomuar në Evangel University dhe ka magjistruar në fushën e administratës publike në Fakultetin e Qeverisë John F. Kennedy të Universitetit të Harvardit.

Flet për "Epokën e re", Artan Murati

Zgjedhjet e 6 tetorit, të

Njohësi i proceseve politike dhe zgjedhore, njëherësh menaxher i projektit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) për monitorimin e Kuvendit të Kosovës, Artan Murati, ka thënë se në fushatë ka pasur garë më të gjerë mes kandidatëve për kryeministër dhe partitë politike janë treguar më të disiplinuar për respektimin e kodit të mirësjelljes. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se zgjedhjet e 6 tetorit do të jenë të paparashikueshme dhe shumë të ngushta në mes të subjekteve kryesore politike. Murati ka theksuar se këto zgjedhje duhet të prodhojnë institucione të besueshme dhe të afta për të punuar për të mirën e qytetarëve



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 4 TETOR - Menaxheri i projektit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) për monitorimin e Kuvendit të Kosovës dhe njohësi i proceseve zgjedhore dhe politike,

Artan Murati, ka thënë të premtën se në fushatën për zgjedhjet e 6 tetorit ka pasur garë më të gjerë mes kandidatëve për kryeministër dhe partitë politike janë treguar më të disiplinuar për respektimin e Kodit të Mirësjelljes. "Sa iu përket programeve, pothuajse

të gjitha subjektet kanë prekur çështjet kryesore të cilat shqetësojnë qytetarët dhe ndërlidhen me zhvillimet e përgjithshme politike e sociale në vend", ka deklaruar Murati në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re". Ai ka thënë se zgjedhjet e 6

tetorit do të jetë të paparashikueshme dhe shumë të ngushta mes subjekteve kryesore politike. Sipas Muratit, këto zgjedhje duhet të prodhojnë institucione kredibile dhe të afta për të punuar për të mirën e qytetarëve. "Numri i lartë i papunësisë,

zhvillimi ekonomik, sundimi i rendit dhe ligjit, funksionalizimi i arsimit dhe shëndetësisë janë vetëm disa prej çështjeve urgjente që duhet të trajtohen denjësisht nga institucionet që dalin pas zgjedhjeve të 6 tetorit, andaj rrjedhimisht qytetarët duhet të dalin sa më

SBASHK-u fton mësimdhënësit të dalin në zgjedhje

PRISHTINË, 4 TETOR - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) u ka bërë thirrje të gjithë mësimdhënësve që

të dalin në zgjedhjet e 6 tetorit. "SBASHK-u iu drejtohet tani të punësuarve në arsim që lirshëm të dalin sa më masivisht më 6 tetor e

të votojnë sipas bindjes së tyre për subjektin a koalicionin garues që ata mendojnë se e meriton besimin e tyre, por apelojmë që në lis-

tat e subjekteve që ata votojnë t'u japin përparësi kandidatëve që vijnë nga sektori i arsimit, me shpresën se ata do ta respektojnë

besimin e mësimdhënësve dhe do të jenë zëri i tyre në institucione dhe në Kuvendin që formohet nga votat e zgjedhjeve të 6 tetorit", është thënë në njoffimin e SBASHK-ut.

paparashikueshme

tarët e vendit", ka theksuar Murati. Ai ka thënë se procesi i dialogut do të jetë një nga çështjet më urgjente me të cilat do të përballet qeveria e re. "Procesi i dialogut do të jetë një nga çështjet më urgjente me të cilat do të përballet qeveria e re. Pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, tanimë është e qartë se kushdo që do të udhëheqë qeverinë do të merret me dialogun me Serbinë", ka deklaruar Murati.

"Epoka e re": Z. Murati, si e vlerësoni fushatën zgjedhore të subjekteve politike dhe kandidatëve për kryeministër?

Murati: Sipas informatave të pranuar nga 72 vëzhguesit tanë në terren, tubimi publik ka qenë forma më e shpeshtë e organizimit që ka dominuar në aktivitetet partiake parazgjedhore. Relativisht i lartë ka qenë numri i ngjarjeve që nuk janë paralajmëruar në KKZ brenda afateve kohore. Moslajmërimi me kohë i ngjarjeve zgjedhore nga subjektet politike e pamundëson informimin e drejtë dhe me kohë të publikut mbi programet e subjekteve politike në garë. Gjuha e përdorur nga kandidatët në fushatë në përgjithësi ishte konform frymës së një fushate të lirë dhe konkurruese. Por, nuk kanë munguar ngjarjet kur kandidatët e subjekteve politike kanë drejtuar mesazhe fyese për kundërshtarët e tyre mbi baza partiake. Edhe këtë vit pjesëmarrja e përgjithshme e grave në tubime elektorale nuk ka kaluar më shumë se 25 për qind të numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve, kurse subjektet politike në përgjithësi kanë pasur tendencë të përdorimit të resurseve publike, sidomos veturave zyrtare dhe shërbyesve civilë. Në raport me shkeljet e rregullave të fushatës, DnV-ja ka dorëzuar gjithsej 15 ankesa në PZAP, 10 prej të cilave janë miratuar (vlera e gjobave, 49 550 euro), 1 është refuzuar dhe 4 janë në pritje për shqyrtim. Në përgjithësi kandidatët për kryeministër kanë pasur mundësi të mjaftueshme për t'i shpalosur programet elektorale sepse fushata parazgjedhore veçse ka filluar që nga

koha kur ish-kryeministri Haradinaj dha dorëheqje.

"Epoka e re": Në këtë fushatë, për dallim nga të kaluarat, a ka ndonjë avancim në prezantimin e programeve, në garën ndërmjet pretendentëve kryesorë të garës?

Murati: Kësaj radhe ka pasur garë më të gjerë mes kandidatëve të subjekteve politike me qëllim që të post e pretendojnë së paku katër figura politike me ambicie të mëdha për detyrën e kryeministrit. Subjektet politike janë shfaqur disi më të disiplinuar për respektimin e kodit të mirësjelljes, sidomos përdorimin e posterëve dhe materialeve propaganduese. Fushata ka qenë më shumë e fokusuar në diskutim me qytetarët si dhe fushatë e realizuar përmes rrjeteve sociale. Besoj se ka qenë e pashmangshme nga të gjithë përdoruesit e rrjeteve sociale shikimi i postimeve të shumta të sponsorizuara nga subjektet, por edhe kandidatët individualisht. Sa iu përket programeve, pothuajse të gjitha subjektet kanë prekur çështjet kryesore të cilat i shqetësojnë qytetarët dhe ndërlihdhen me zhvillimet e përgjithshme politike dhe sociale në vend. Pra, do të ishte e vështirë të veçohet ndonjë subjekt nga tjetri sa i përket agjendës së çështjeve që kanë dominuar diskursin politik përgjatë fushatës.

"Epoka e re": Çfarë prisni nga zgjedhjet e 6 tetorit?

Murati: Nëse për asgjë tjetër, këto zgjedhje mund të mbahen në mend si zgjedhje të paparashikueshme dhe shumë të ngushta mes subjekteve kryesore politike. Zgjedhjet e 6 tetorit duhet të prodhojnë institucione kredibile e të afta për të punuar për të mirën e qytetarëve të vendit. Republika e Kosovës gjendet në udhëkryq në aspekt të politikës së jashtme e, po ashtu, me sfida të mëdha në jetën e përditshme të qytetarëve të vendit. Numri i lartë i papunësisë, zhvillimi ekonomik, sundimi i rendit dhe i ligjit, funksionalizimi i arsimit dhe i shëndetësisë janë vetëm disa prej çështjeve urgjente që

duhet të trajtohen denjësisht nga institucionet që dalin pas zgjedhjeve të 6 tetorit, andaj rrjedhimisht qytetarët duhet të dalin sa më masivisht në zgjedhje për t'u bërë hisedarë në vendimmarrje e në të ardhmen e vendit.

"Epoka e re": Meqenëse ju monitoroni punën e Kuvendit, si do të jetë legjislatura e shtatë?

Murati: Shpresoj se legjislatura e shtatë mos t'i ngjajë asaj paraprakes. Legjislatura e gjashtë ishte ndër më joefikasat në histori të Kuvendit, andaj nuk duhet të merret si shembull se si do të duhej të funksiononte një legjislaturë. Pres që deputetët që do ta marrin mandatin për legjislaturën e shtatë të punojnë me zell, ta marrin seriozisht rolin e tyre dhe ta vlerësojnë peshën e votës që do ta marrin nga qytetarët e vendit. Kosovën e presin procese të rëndësishme andaj deputetët duhet të jenë vigjilentë dhe shumë të përgjegjshëm në punën të cilën do ta kryejnë.

"Epoka e re": Si e shihni ecurinë e procesit të dialogut, të agjendës evropiane etj.?

Murati: Procesi i dialogut do të jetë një nga çështjet më urgjente me të cilat do të përballet qeveria e re. Pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, tanimë është e qartë se kushdo që do ta udhëheqë qeverinë do të merret me dialogun me Serbinë. Po ashtu, në raport me BE-në, qeveria e re do të ketë punë të dyfishtë pasi, përveç fillimit të punës me institucionet e sapokrijura në BE pas zgjedhjeve të qershorit, në të njëjtën kohë duhet të punojë edhe në proceset që tanimë kanë filluar e që kërkojnë zgjidhje. Lobimi për liberalizimin e vizave për qytetarët do të jetë prioritet i qeverisë në ardhje, e bashkë me vizat qeveria do të duhej që me ngulm t'i shtyjë përpara proceset integruese të Republikës së Kosovës për në BE, duke garantuar edhe implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si dhe Agjendën për Reforma Evropiane.

masivisht në zgjedhje për t'u bërë hisedarë në vendimmarrje e në të ardhmen e vendit", është shprehur ai, duke shtuar se legjislatura e shtatë nuk duhet t'i ngjajë asaj paraprakes. "Legjislatura e gjashtë ishte ndër më joefikasat në histori të Kuvendit, andaj nuk

duhet të merret si shembull se si do të duhej të funksiononte një legjislaturë. Pres që deputetët që do ta marrin mandatin për legjislaturën e shtatë të punojnë me zell, ta marrin seriozisht rolin e tyre dhe ta vlerësojnë peshën e votës që do ta marrin nga qyte-

Thaçi dekoron Arqipeshkvin e Tivarit me medaljen "Shën Tereza"

PRISHINË, 4 TETOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka dekoruar me medaljen presidenciale "Shën Tereza" Arqipeshkvin e

Arqipeshkvisë së Tivarit, Don Rrok Gjonllëshaj, për kontribut në fushën e humanizmit dhe paqes. "Me Medaljen Presidenciale 'Shën


Tereza' dekorova Arqipeshkvin e Arqipeshkvisë së Tivarit, Don Rrok Gjonllëshaj, për kontribut në fushën e humanizmit dhe paqes.

Don Rrok Gjonllëshaj vazhdon të kontribuojë për forcimin e marrëdhënieve të mira ndërmjet Selisë së Shenjtë dhe komunitetit

të krishterë, por edhe më të gjerë të botës shqiptare", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Fillon heshtja zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit

NESËR VENDOS



Subjektet politike kanë përfunduar fushatën zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit me tubime madhështore në Prishtinë, Gjilan, Gjakovë dhe Prizren. Kandidatët për kryeministër, në ditën e dhjetë të fushatës, kanë bërë përpjekjen e fundit me premtimet e tyre për t'i bindur qytetarët që t'i votojnë. Në anën tjetër, KQZ-ja, policia, organet e drejtësisë dhe Demokracia në Veprim kanë bërë me dije se janë bërë të gjitha përgatitjet për procesin zgjedhor. Të dielën do të garojnë 25 subjekte politike dhe të drejtë vote do të kenë 1 937 869 qytetarë të Republikës së Kosovës

**EPOKA
ERE**
Muhamet KOCI

PRISHTINË, 4 TETOR - Partitë politike kanë mbyllur fushatën zgjedhore me tubime më të mëdha sesa në ditët e tjera. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) me takime përmbyllëse në Prishtinë, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në Gjilan, koalicioni AAK-PSD në Gjakovë dhe koalicioni Nisma-AKR-PD janë munduar ta bindin votuesin kosovar për t'i votuar kandidatët e tyre për kryeministër në zgjedhjet e parakohshme

parlamentare të 6 tetorit.

Pesë kandidatët për kryeministër në përmbyllje të fushatës e kanë vlerësuar si datë shumë të rëndësishme për të ardhmen e vendit ditën e zgjedhjeve, 6 tetorin. Ndërkohë, institucionet janë bashkërenduar që procesi zgjedhor të shkojë sipas standardeve më të larta demokratike.

Në një konferencë të përbashkët për media, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa, Prokurori i Shtetit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Policia e Kosovës dhe përfaqësuesit nga Demokracia në

Veprim kanë nënshkruar një memorandum të bashkëpunimit për procesin zgjedhor, për parandalimin e shkeljeve ligjore dhe hetimin dhe ndjekjen e të gjitha rasteve që bien ndesh me ligjin.

Drejtori i Departamentit për Çështje Ligjore në KQZ, Xhemail Peçani, ka treguar se në zgjedhjet e 6 tetorit do të jenë 895 qendra të votimit apo katër qendra më pak se në zgjedhjet e vitit 2017. "Janë emëruar 258 komisione komunale në 38 komuna të Republikës të Kosovës. I gjithë materiali sensitiv është në depot e komisioneve

komunale. Materiali sensitiv qysh nga dita e nesërme, me ndihmën e Policisë të Kosovës, do të distribuohet prej depot të KQZ-së në depot e komisioneve komunale të zgjedhjeve, i cili besojmë se ditën e zgjedhjeve do të jetë në të gjitha qendrat e votimit. Qendra e numërimit të rezultateve gjendet në fazën e operimit të saj dhe është e gatshme me të gjitha kapacitetet. Janë emëruar mbi 17 921 anëtarë të këshillave të vendvotimeve në të gjitha komunat. Është certifikuar edhe lista përfundimtare e votuesve e cila përmban 1 milion e 937 mijë e 869 votues me të drejtë vote, për dallim prej zgjedhjeve lokale të 2017-s, janë 111 733 votues më shumë në krahasim me këto zgjedhje", ka thënë Peçani. Laura Pula, koordinatore nacionale për zgjedhje në Prokurorinë e Shtetit, ka shprehur shpresën e saj që zgjedhjet të jenë ditë feste për të gjithë. "Tashmë e kemi caktuar dhomën operative me staf të mjaftueshëm, i cili do të jetë 'online' me të gjitha qendrat në nivel vendi, me të gjitha

prokuroritë themelore, shtatë sosh, dhe së bashku me koordinatoret rajonale të komunave, të cilët mbajnë përgjegjësinë dhe obligimet për të vepruar në regjionet e tyre dhe me obligim të posaçëm për të treguar të gjitha veprimet e kundërligjshme që mund të ndodhin ditën e zgjedhjeve", ka thënë Pula. Kurse zëvendëskryesuesja e Këshilli Gjyqësor, Makifete Saliuka, është zotuar se do ta trajtojë çdo rast që do të iniciohet nga prokuroria. "Ne si Këshill zotohemi që të gjitha rastet e pranuar nga Prokuroria e Kosovës lidhur me keqpërdorimet në zgjedhje do të trajtohen nga gjykatat si lëndë me prioritet. Përveç kësaj, zotohemi se ekzekutimi i vendimeve të lëshuara nga gjykatat do të bëhet me kohë dhe në mënyrë efikase", ka thënë ajo. Ndërsa Gyltene Sylejmani, kryesuese e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa, ka bërë me dije se deri më tash janë parashtruar 210 ankesa dhe panele. "LDK-së i janë shqiptuar

SOVRANI



Arrijnë mbi 8 000 fletëvotime nga diaspora

Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka bërë me dije se deri më 3 tetor në Prishtinë kanë arritur 8 133 pako të supozuara me fletëvotime nga diaspora. Ai ka thënë se votuesit jashtë vendit përmes postës kanë kohë që deri sot (5 tetor) të votojnë për zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit. Elezi ka thënë se numërimi i fletëvotimeve të supozuara që kanë ardhur përmes postës do të

bëhet pas ditës së zgjedhjeve, në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve, ku do të numërohen edhe votat me kusht dhe votat e personave me aftësi të kufizuar. Kujtojmë se nga 40 313 aplikacione për të votuar përmes postës që janë pranuar dhe proceduar në KQZ, janë aprovuar 35 087 aplikacione, ndërsa janë refuzuar 5 226 aplikacione për shkak të mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara me ligj.

Nga Demokracia në Veprim në këtë konferencë ka folur Florent Spahija, i cili ka deklaruar se për zgjedhje kanë të angazhuar 72 vëzhgues në periudhë afatgjatë, ndërsa në ditën e zgjedhjeve do të jenë edhe 2 600 vëzhgues të cilët do të jenë në secilin vendvotim.

Daka paralajmëron komisionarët nëse manipulohen votat

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, ka paralajmëruar komisionarët e partive politike nëse do të ketë tentime për manipulim të votave. Në mbledhjen e KQZ-së të mbajtur të premten, Daka ka thënë se, nëse shkaktojnë ndonjë parregullsi, do të ngrehet kallëzim penal ndaj tyre. "Në ditën e zgjedhjeve, por edhe pas përfundimit të zgjedhjeve, gjatë numërimit të votave dhe gjatë përfundimit të procesit të ditës së zgjedhjeve të gjithë komisionarët të cilët do të kenë edhe një dyshim më të vogël, jo dyshim të bazuar ashtu siç kërkohet nga Kodi Penal, por edhe një dyshim më të vogël se kanë bërë manipulimin e kandidatëve apo votave të kandidatëve, apo

votave të subjekteve politike, do të ngrehen kallëzime penale në ditën e zgjedhjeve dhe pas ditës së zgjedhjeve drejtpërdrejt nga KQZ-ja. Ndërkaq gjatë auditimit të kutive të votimit të cilat do të arrijnë në QNR do të bëhen këto kallëzime penale të drejtpërdrejta në prokuroritë përkatëse", ka deklaruar Daka.

E para e KQZ-së të premten ka takuar edhe presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, me të cilin ka biseduar për rrjedhat e deritashme të procesit zgjedhor. Shefi i shtetit ka shprehur besimin se zgjedhjet parlamentare do të jenë të lira, korrekte dhe gjithëpërfshirëse. "Falënderova kryetaren Daka dhe KQZ-në për përgatitjen e suksesshme të zgjedhjeve me bindjen se edhe kësaj here qytetarët dhe subjektet politike do ta dëshmojnë pjekurinë e tyre", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Të dielën do të garojnë 25 subjekte politike dhe të drejtë vote do të kenë 1 937 869 qytetarë të Republikës së Kosovës. Numri i përgjithshëm i kandidatëve të certifikuar për këto zgjedhje është 1 067 kandidatë për deputetë, prej tyre 724 meshkuj dhe 343 femra.

32 700 euro, PDK-së 52 500 euro, Listës Serbe 36 100 euro, koalicionit AAK-PSD 28 800 euro, koalicionit Nisma-AKR-PD 2 500 euro. Gjithsej dënime janë shqiptuar 154 450 euro. Në procedurë e sipër janë edhe shumë ankesa, mbi 40 që janë në zhvillim e sipër, kështu që ky numër nuk është përfundimtar", ka deklaruar Sylejmani.

Thaçi i shqetësuar me mundësinë e frikësimit të votuesve serbë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të premten një delegacion të misionit vëzhgues të zgjedhjeve të Parlamentit Evropian, kryesuar nga deputetja Viola von Cramon-Taubadel, të cilët i ka falënderuar për kontributin e tyre për mbarëvajtjen e zgjedhjeve në Kosovë. Gjatë këtij takimi presidenti Thaçi është shprehur i shqetësuar me raportet për intimidim të votuesve serbë në veri të

Kosovës. Ai i ka ftuar vëzhguesit që të jenë në veri dhe të raportojnë për çdo gjë që do të vërehet. Presidenti Thaçi ka shprehur mirënjohjen për përkrahjen që institucionet e BE-së i kanë dhënë vazhdimisht Kosovës për forcimin e institucioneve dhe parimeve demokratike. "Jemi mirënjohës për rolin tuaj në monitorim të zgjedhjeve, por edhe për rekomandimet që jepni si mënyrë për ta përmirë-

suar edhe më tepër procesin elektoral në Kosovë", ka theksuar presidenti Thaçi. Kurse anëtarja e Parlamentit Evropian, Viola von Cramon-Taubadel, është shprehur e kënaqur që Parlamenti Evropian do t'i monitorojë edhe këto zgjedhje dhe ka kërkuar që rekomandimet që ka dhënë, e që do të japë ky mision vëzhgues, të merren parasysh nga institucionet e Kosovës.

Lobi i Grave të Rajonit: Qytetarët të votojnë për programet dhe për më shumë gra

PRISHTINË, 4 TETOR (ER)- Lobi Rajonal i Grave për Evropën Juglindore (LRGEJL) i drejtuar nga kryetarja dhe ish-zëvendëskryeministrja, Edita Tahiri, nëpërmjet një komunikate për medie ka vlerësuar se zgjedhjet e parakohshme më 6 tetor janë një rast i mirë për qytetarët për votuar për programet dhe jo liderët e partive, duke legjitimuar një qeverisje demokratike që do të punojë për të mirën e qytetarëve, komuniteteve dhe shtetit të Kosovës. LRGEJL konsideron se demokracia e vërtet është një demokraci gjithëpërfshirëse e cila mundëson barazinë gjinore dhe mundësi të barabarta për secilin qytetarë. Lobi i Grave të Rajonit u ka bërë thirrje qytetarëve që të votojnë sa më shumë gra kandidatë për parlament, të cila kanë aftësi të dëshmuara dhe janë të devotshme për të çuar përpara interesat e qytetarëve dhe të vendit tonë. "Duke mirënjohur përparimet në fushën e barazisë gjinore por të shqetësuar se procesi i fuqizimit të grave po shkon nga dale, Lobi i

Grave të Rajonit ju bëjnë thirrje qytetarëve që të votojnë sa më shumë gra kandidatë për parlament, të cila kanë aftësi të dëshmuara dhe janë të devotshme për të çuar përpara interesat e qytetarëve dhe të vendit tonë", është thënë në këtë komunikatë.

LRGEJL duke uruar për një proces zgjedhor të ndershëm dhe demokratik rikujton se investimi për fuqizimin e grave është investim për ardhmërinë më të ndritur të Kosovës. "Gratë janë gjysma e popullatës tonë, ato janë një faktor strategjik për zhvillimin dhe përparimin e vendit, përparimin e ekonomisë, luftojnë me sinqeritet korrupsionin duke mundësuar hapjen e vendeve të punës dhe ndaljen e ikjes së rinisë nga Kosova. Duke uruar për një proces zgjedhor të ndershëm dhe demokratik të liru nga dukuri negative që i kemi parë më herët, ju kujtojmë se investimi për fuqizimin e grave është investim për ardhmërinë më të ndritur të Kosovës", është theksuar më tutje në deklaratën e Lobit të Grave të Rajonit.



Diaspora në pasqyrën e thyer të perceptimit

Që të mos ndodhë perceptimi për diasporën në pasqyrën e thyer, duhet të ndryshojë qasja ndaj saj, në radhë të parë nga ata që pas 6 tetorit marrin obligim ta përfshijnë kontributin e diasporës jo vetëm me remitencat familjare por, mbi të gjitha, me investimet që mund të shkojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës. Rëndësia pse duhet të ndodhë ndryshimi i madh me këto zgjedhje lidhet edhe me diasporën, sidomos me borxhin që duhet kthyer asaj për gjithë kontributin e dhënë në dekadat e fundit



Nga Mehmet PRISHTINA

Perceptimi për diasporën ende lëviz brenda një kuadri të ngushtë kuptimesh të reduktuara, ku kryesisht dominon komponenti i ndihmës financiare dedikuar familjeve në vendlindje. Por, në fakt, ky perceptim në vetvete ngërthen një paradoks bukur të madh për arsye se padrejtësisht atributet për dias-

porën kufizohen vetëm në suaza të dimensionit social dhe sikur harrohen apo padrejtësisht nuk afirmohen sa duhet, dimensionet e tjera, që janë edhe thelbi i misionit të diasporës në dekadat e fundit.

Në radhë të parë diaspora e njerëzve tanë të larguar nga vendlindjet e tyre ishte një grumbullim energjish në vende të lira ku ndikimi dhe prania e regjimeve antishqiptare ishte e përmasave marginale. Vendet e Evropës dhe përtej Atlantikut u bënë foletë e ngrohta ku njeriu i shkullur shqiptar thuri ëndrrën për një Kosovë të lirë. Ashtu edhe ndodhi, por jo vetvetiu.

Organizimi i përkryer i diasporës sonë, sidomos lobimi pro çështjes shqiptare që u fut në

agjendat e diplomacive euoamerikane, ishin meritë kryekëput e njerëzve tanë në emigracion. Falë këtij lobimi Kosova arriti të depërtojë në Kongresin dhe Senatën Amerikan, kurse përfaqësuesit kosovarë arritën shpesh më t'i artikulojnë idetë dhe kërkesat e tyre për shtetin e lirë e të pavarur të Kosovës.

Tani kur dëgjojmë të flitet për diasporën, njerëzve instinktivisht mendja iu shkon te remitencat. Pra, diaspora jonë ende perceptohet si 'bankomat', ndërkohë që anashkalohen dimensionet e tjera më të qenësishme që lidhen me misionin e saj. Por, ky perceptim nuk ka ardhur vetvetiu. Diskursi publik për këtë perceptim është krijuar

në radhë të parë nga vetë popullata, e cila të vetmen alternativë të sigurt të gjallimit e ka pikërisht lidhjen me diasporën, konkretisht me njerëzit e afërt të familjes. Milionat që aktualisht dërgohen në Kosovë nga diaspora janë një konkurrencë e fortë që i bëhet buxhetit shtetëror, i cili nuk po arrin të krijojë stabilitet të mirëfilltë ekonomik dhe mirëqenie afatgjatë sociale. Analizat e institucioneve financiare ndërkombëtare sugjerojnë që këto dërgesa në njërën anë e mbajnë gjallë kondicionin social në Kosovë, në anën tjetër krijojnë shprehje të keqe të rinjtë, të cilët mendojnë se pa punuar mund të fitosh para.

Megjithatë, arsyeja kryesore pse janë krijuar këto perceptime për diasporën qëndron në faktorin shtet. Kosova ende nuk ka arritur të sigurojë një legjislacion të qëndrueshëm i cili do të ishte garanci e investimeve nga diaspora. Ka shumë biznesmenë sot në diasporë të cilët më të rëndësishme se fitimin e kanë garancinë për të mos humbur investimin. Dihet që garancitë i jep vetëm shteti i së drejtës, i cili është në gjendje ta krijojë

kulturën e nikoqirllëkut të mirë, ku secili ndihet komod me biznesin e tij sepse në fund shtetin e ka aleat në çfarëdo situatë.

Shtetet si Greqia, Spanja, Portugalia, Hungaria, Polonia etj. krijuan infrastrukturë mjaft të zhvilluar ligjore përmes së cilës investimet nga diaspora ishin të garantuara me dorën e kujdesshme të shtetit.

Kosova nuk është ishull i vetmuar për të mos përvetësuar këto modele të mira, kurse kjo mund të bëhet realitet pas zgjedhjeve të 6 tetorit. Që të mos ndodhë perceptimi për diasporën në pasqyrën e thyer, duhet të ndryshojë qasja ndaj saj, në radhë të parë nga ata që pas 6 tetorit marrin obligim ta përfshijnë kontributin e diasporës jo vetëm me remitencat familjare por, mbi të gjitha, me investimet që mund të shkojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik e social të Kosovës.

Rëndësia pse duhet të ndodhë ndryshimi i madh me këto zgjedhje, lidhet edhe me diasporën dhe sidomos me borxhin që duhet kthyer asaj për gjithë kontributin e dhënë në dekadat e fundit.

Ana e gabuar e historisë është shumë e populluar



Oliver BURKEMAN

Në fillim të muajit, ndërkohë që ajo masë impulsesh konfuze që aktualisht mbulon detyrën e presidentit të Shteteve të Bashkuara përgatitej që të shkonte në Londër, kryetari i bashkisë së qytetit, Sadiq Khan, deklaroi për "The Guardian" se ajo vizitë do ta fuste Mbretërinë e Bashkuar "në anën e gabuar të historisë".

Kam prirjen të jem dakord me të, që do të ishte më mirë të shmangej ai udhëtim, në mos për të tjerat, për faktin se është rrezikuar racionimi i cheesburg-

erave, por është koha që t'i japim fund historisë së "anës së gabuar të historisë". Ashtu si hapësira mes jastëkëve të divanit, që mbushet me monedha dhe copëza plastelina, u bënë disa vjet që ana e gabuar e historisë është populluar shumë.

Mes atyre që kanë hyrë janë tifozët e Brexitit, ata që janë no vax, ata që janë pro vax, feministët që nuk pranojnë idenë e gjinive si fakt absolut, politika e majtë somalo-amerikane Ilhan Omar dhe Benjamin Netanjahu.

Koha është përparim

Kur revista online "Vox" i kërkoi një komisioni ekspertësh se për çfarë do të na vijë turp pas pesëdhjetë vjetësh, përgjigjet kanë përfshirë luftën ndaj drogës, ligjet që pengojnë blerjen e shërbimeve seksuale dhe faktin që jemi mishngrënës. Por, ndoshta, ajo gjë për të cilën duhet të turpërohemi vërtet,

është se kemi këmbëngulur mbi konceptin e anës së duhur dhe anës së gabuar të historisë.

Dyshimi më lindi kur studiuesja e etikës, Karen Prior, në përgjigje të pyetjes së "Vox"-it, tha se një prej gjërave që të gjithë i konsiderojmë tmerr do të jetë aborti. Progresisti mesatar natyrisht se do të protestojë fort. Po si mund të jemi të sigurt që Prior gabon? T'i bësh apel gjykimit të historisë, do të thotë të imagjinosh si do ta mendojë një grup njerëzish në të ardhmen, kështu që nuk ka përse të habitemi nëse do të jenë dakord, me cilindo që do të kërkojë mendimin e tyre.

Çështja nuk është se përgjatë historisë jo gjithçka përmirësohet. Supozoj që jemi të gjithë dakord mbi faktin që bota është një vend më i mirë, tani që jetëgjatësia është rritur, gratë kanë të drejtën e votës dhe lija është zhdukur. Ideja e gabuar është që të presim një përmirësim

progresiv të gjërave, thjesht, falë kalimit të kohës. Për t'i përdorur fjalët e politologut Jacob Levy: "Të kuptosh dhe të bësh gjënë e duhur, është e vështirë; është një luftë që i paraqitet çdo individit dhe çdo brezi. Ideologjia e historisë si progres moral përpiket të na bëjë që të na duket e lehtë".

Një ide e mirë

Kryebashkiaku Khan është deklaruar kundër vizitës së Trumpit sepse "e djathta ekstreme është në ngjitje në të gjithë botën dhe rrezikon t'i anulojë të drejtat dhe liritë që i kemi fituar me mund" dhe kush mund të thotë se gabohet? Por kjo ndihmon që të kuptojmë më mirë, përse ideja e "anës së gabuar të historisë" nuk ka kuptim. Nëse në fund do të garantohet humbja e të djathtës ekstreme, do të kishim shumë më pak gjëra për t'u shqetësuar.

Ndërsa rreziku i vërtetë vjen kur, në ditët e sotme, këtë ide e përdorin urëndërtuesit modernë për të mos marrë në konsideratë mundësinë, që mund të jenë ata që gabojnë. Nëse je i sigurt se historia do të të japë të drejtë, nuk ka nevojë që të sforcosh për të kuptuar se kush e mendon ndryshe nga ti: të mjafton ta eliminosh duke thënë se është një dinozaur dhe nuk vetëdijësohet për përparimin që ka bërë etika.

Paradoksi është se në realitet është ide e mirë të reflektosh mbi gjykimin e historisë jo për t'i konfirmuar opinionet tona, por për t'i vënë në diskutim dhe përshatur një qasje më të përlulur. Në të kaluarën ka pasur shumë periudha kur njerëzit prisnin gjëra të tmerrshme apo qesharake por, me sa duket, nuk i konsideronte të tilla. Pse ne duhet të jemi imunë nga kjo gjë, vetëm prej faktit që jetojmë tani? (*The Guardian - Bota.al*)

"Forbes" publikon listën, ja 10 femrat më të pasura në botë për vitin 2019

Sipas renditjes së Forbes në "Miliarderët e Botës", ka gjithsej 239 femra në listë këtë vit, që vijnë nga vende të ndryshme të botës dhe industri të ndryshme si minierat, pasuritë e patundshme,

financat, farmaceutika, dhe të tjera.

Përveç parave të arritura nga vetë femrat nëpërmjet bizneseve dhe industrive të ndryshme, një pjesë e tyre përbëhet edhe nga paratë e

trashëguara.

Lista e 10 femrave më të pasura në botë është gjithashtu mjaft interesante për një gjë: mungesa e diversitetit.

Është vetëm një femër aziatike

pjesë e listës së 10 femrave më të pasura. Pjesa tjetër është nga perëndimi. Kjo gjë dëmton bisedimet për shpërndarjen e pasurisë në një ekonomi të globalizuar, shkruan "scantv".



ASK-ja: Në vitin 2018 mbi 13 000 persona u punësuan në shëndetësi

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), numri i përgjithshëm i të punësuarve në shëndetësi në sektorin publik në vitin 2018 ishte 13 180 persona, prej tyre 3 486 persona ishin mjekë specialistë, 8 226 infermierë dhe 1 468 staf jomjekësor

shëndetësi në sektorin publik në vitin 2018 ishte 13 180 persona, prej tyre 3 486 persona ishin mjekë specialistë, 8 226 infermierë dhe 1 468 staf jomjekësor. "Numri i përgjithshëm i shërbimeve të ofruara nga qendrat e mjekësisë familjare ishte 13215001 shërbime, prej tyre: në mjekësi familjare ishin 413 638 vizita; në stomatologji 683 133 vizita, në laboratorë 266 598 0 shërbime si dhe në intervenime dhe shërbime të veçanta 458 242 2 sosh", thuhet në raportin e ASK-së.

Sipas këtij raporti, në spitalet e përgjithshme kishte 381 340 ditë shërimi me 842 22 pacientë të shtrirë, ku 18 376 pacientë ishin operuar. "Po ashtu, janë realizuar 825 381 vizita ambulantore, ndërsa shërbime (parametra) laboratorike janë kryer 157 183 6. Gjatë vitit 2018 në Qendrën Klinike Universitare kanë qenë 465 488 ditë shërimi me 78 791 pacientë të shtrirë, ku 22 715 prej tyre janë operuar. Gjithashtu, janë realizuar

rreth 352 377 vizita diagnostike për pacientë, 515 033 vizita ambulatorie, 293 078 7 shërbime laboratorike dhe 551 036 shërbime të veçanta. Në Qendrën Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës (QKSUK) janë realizuar 330 522 shërbime stomatologjike në total, prej tyre rreth 51 829 vizita kontrolluese, 81 757 shërbime për pacientë jashtë Prishtinës etj", është thënë në raportin e ASK-së, duke shtuar se numri i rasteve të identifikuar dhe të trajtuara me sëmundje malinje dhe beninje, gjatë vitit 2018, ishte 2 475 raste, ndërsa numri më i madh i të prekurve me sëmundje malinje dhe beninje i përkiste grupmoshës 60-64 vjeç, me gjithsej 392 raste, ose shprehur në përqindje 15.9 për qind. "Numri i dializave të realizuara gjatë vitit 2018, në të gjitha spitalet publike të Kosovës, ishte 124 446 raste. Ndërsa numri i shërbimeve nga qendrat profesionale të shëndetit mendor ishte 352 380. Numri

i të prekurve me TBC kishte 702 raste, prej tyre 338 ishin femra dhe 364 meshkuj. Numri i të vdekurve nga sëmundjet ngjitëse ishte 63, ku numri më i madh i të vdekurve ishte nga sëmundja Sepsis me gjithsej 21 persona, ose 33.3 për qind. Në bazë të odave të profesionistëve shëndetësorë në Kosovë ka 19 241 punonjës shëndetësorë të licencuar, prej tyre 13 441 janë femra dhe 5 800 janë meshkuj", është thënë në raportin e ASK-së.

Sipas këtij raporti, numri i institucioneve private shëndetësore të licencuara ka arritur në 1 592, prej tyre 27 spitale dhe 1 565 institucione të tjera shëndetësore si: ambulanca, poliklinika etj. "Nga gjithsej 1 592 institucione private shëndetësore të licencuara, numrin më të madh e përbëjnë ambulancat stomatologjike me 418, ose 26.25 për qind e numrit të përgjithshëm të institucioneve të licencuara private", është thënë në raportin e ASK-së.

EPOKA E RE**Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 TETOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e shëndetësisë për vitin 2018. Ky publikim ofron të dhëna për numrin e përgjithshëm të të punësuarve në institucionet publike shëndetësore sipas gjinisë, shkallës së arsimit të tyre, të dhëna për personat e licencuar për t'i kryer aktivitetet shëndetësore në insti-

tucionet shtetërore ose private në Republikën e Kosovës.

Po ashtu, ky publikim ofron të dhëna për aktivitetet e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), aktivitetet e spitaleve të përgjithshme, vizitat në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare, institucionet private të licencuara, shërbimet paraklinike, të sëmurit me TBC, sëmundjet ngjitëse etj. Sipas rezultateve të dalta nga ky publikim, rezultoi se numri i përgjithshëm i të punësuarve në



SHIFK nis bashkëpunimin me Odën Ekonomike të Kosovës

PRISHTINË, 4 TETOR (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi (OEK), ka pritur në takim drejtorin ekzekutiv të Shoqatës së Inovacionit Financiar të Kosovës, Venhar Hana. Në këtë takim Hana ka njoftuar kryetarin e OEK-ut, Berat Rukiqi, lidhur me qëllimin, misionin dhe aktivitetet e SHIFK, duke potencuar nevojën e themelimit dhe rritjes së bashkëpunimit institucional, me qëllim të zhvillimit dhe promovimit sa më të mirë të sektorit

financiar jobankar në Kosovë, duke ndjekur trendet e fundit për avancimin e kësaj industrie në rajon dhe botë.


Ndërkaq Rukiqi ka mirëpritur iniciativën për këtë bashkëpunim, duke theksuar se bashkërisht OEK-u dhe SHIFK mund të punojnë në drejtim të dhënies së kontributit profesional për lobimin në nismat ligjore, ngritjen e çështjeve të caktuara me interes të përbashkët për trajtim nga institucionet përgjegjëse, rritjen e nivelit të përfshirjes financiare në vend si

dhe vlerësimin e modaliteteve për promovimin e mundësisë që kanë institucionet financiare në përgjithësi në zgjidhjen e kontesteve në mënyra alternative, siç është ajo përmes Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit pranë OEK-ut.

Në përfundim të takimit palët janë pajtuar që intensivisht të punojnë që brenda një kohe shumë të shkurtër ta formalizojnë bashkëpunimin ndër-institucional përmes nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit.



FITUESI I ZGJEDHJEVE TË 6 TETORIT DO TË JETË HUMBËSI MË I MADH



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

Për moral dhe parime: Sa ishim në llogoret e ish-Jugosllavisë, si të dënuar politikë, ndjenim shumë nevojë t'i përcillnim zhvillimet gjatë shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, në përgjithësi kurse në Kosovë, në veçanti. Është interesant fakti se një i burgosur, qoftë nëse mbahet edhe në izolim të plotë, i nihatë ndryshimet që ndodhin jashtë burgut. Ky rregull vliente edhe për afërsisht 50 të burgosur politikë shqiptarë në llogoren Stara Gradishka në Kroaci në vitin 1989 ku ishim bashkë me kuptimin dhe përmbajtjen e përpjekjeve për çlirim, liri dhe bashkim kombëtar, Bacën Adem Demaçi. Në atë kohë, për të qenë në rrjedha të informimit, pa pyetur fare për çmim, e blemë një transistor nga i cili dëgjoni lajmet e Radio Tiranës, BBC-së, Zërit të Amerikës, RFI, Dojçe Welles, radiot serbe, kroate, sllovene dhe programet e tjera në gjuhën që e kuptoni. Një inxhinier kroat, i dënuar si nacionalist kroat, nga një kuti plasmasi e sapunit e improvizoi një radio që e mbanim rezervë në rast se policia, gjatë bastisjeve të shpeshta, e konfiskonte radion e parë. Me bateri furnizoheshim gjatë vizitave me ç'rast gardianët shqiptarë që kishin ardhur nga Kosova për të burgosurit politikë shqiptarë, mbyllnin njërin sy dhe nuk na kontrollonin shumë. Gjithashtu, bateritë i blinin nga të burgosurit ordinerë dhe i paguanim me duhan. Në atë kohë kishte zhvillime në Kosovë që ndikonin në ngritjen e moralit edhe te ne. Në vitin 1989 u themelua KMDLNj, më vonë edhe LDK-ja që udhëhoq nga Ibrahim Rugova, një intelektual për të cilin nuk kishim shumë informatave përveç paraqitjeve në media dhe në Francuska 7 në Beograd. Baca Adem Demaçi na sugjeroi ta përkrahim Rugovën 100 për qind duke thënë se: "Për herë të parë në krye të një rezistence po vjen një person që po përfaqëson dhe mbron një kërkesë të drejtë...". Natyrisht se të burgosurit politikë shqiptarë në llogoret e ish-Jugosllavisë, kur e krahasonin Ibrahim Rugovën me Azem Vllasin, Rrahman Morinën, Remzi Kolgecin, Ali Shukrinë, Sinan Hasanin dhe të tjerët, na dukej se ishte ringjallur vetë Gjergj Kastrioti - Skënderbeu. Më vonë u zhgënjëm keqas për shkak të mosgatishmërisë së Ibrahim Rugovës për të marrë përgjegjësi për luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Madje jo që nuk e

përkrahi këtë luftë, por e pengoi me aq sa pati mundësi! Barra e dëgjimit të lajmeve binte ekskluzivisht mbi Bacën Adem për faktin se kishte një kujtesë të mahnitshme dhe kuptonte disa gjuhë të huaja, kurse gjuhët sllave i dinte shumë mirë. Pastaj, në çdo mëngjes, para se të shpërndaheshim në vende të punës, na informonte shkurtimisht për lajmet më të rëndësishme për Kosovën. Pas një kohe Baca Adem ma dha radion mua, pasi kisha një kujtesë mesatare dhe njihja shumë mirë gjuhët sllave e që unë, pasi i dëgjoja lajmet, në mëngjes ua komunikoja të burgosurve politikë shqiptarë. Gjithmonë filloja me lajmet e Radio Tiranës duke thënë se, nga 100 për qind lajme të dëguara, nuk besoj në 80 për qind prej tyre. Kisha shokë të mrekullueshëm në llogoret e ish-Jugosllavisë e që ishim në gjendje që në çdo kohë të sakrifkoheshim për njëri-tjetrin, por se kishim dallime të mëdha dhe mospajtime për regjimin në Shqipëri dhe shokun Enver. Unë deklarohesha si demokrat dhe isha për sistem shumëpartiak e që e kisha përkrahjen e Dr. Hafir Shalës - Filit dhe Avdullah Dërgutit - Dul Tarakut. Më së shumti kritikohesha nga Baraleci që, pas daljes nga burgu, nga një kooperativist shembullor i Enver Hoxhës u bë kapitalist konstruktiv. Dr. Haki Gashi, një njeri dhe patriot i jashtëzakonshëm, nuk pajtohej me mua, por se ishte shumë konstruktiv për faktin se çështjen kombëtare e kishte mbi interesat personale dhe ideologjike. Rasti i dr. Haki Gashit është shembull tipik se të qenit i ndershëm dhe i pakorruptueshëm është pengesë për karrierë politike. Për këtë arsye nuk pati jetë të gjatë politike pas luftës si nënkryetar i Therandës dhe sigurisht për këtë arsye nuk u përfshi në listën zgjedhore të PDK-së për zgjedhjet e 6 tetorit. Nejshe, disa më kundërshtojnë me sloganin e Ramiz Alisë se: "Bar do të hamë, por nuk largohe mi nga rruga e marksizëm-leninizmit...". Baca Adem atëherë u thoshte: "Lëreni more marksizëm-leninizmin se nuk ka lidhje me historinë kombëtare, por kapuni pas historisë dhe gjuhës shqipe...". Në atë kohë ka qenë shumë rrezik për jetën të jesh i burgosur politik shqiptar, keni jetuar nga dita në ditë, pa qenë i sigurt se ditën tjetër do të jeni të gjallë. Edhe më shumë kanë vuajtur familjet tona jo nga serbët sa nga serbët shqiptarë që, për fat të keq, gjuhën amtare e kishin gjuhën shqipe. Të burgosurit politikë shqiptarë janë treguar të butë dhe bashkëpunues edhe me torturesit e tyre, prokurorët dhe gjykatësit që i kanë dënuar. Familjet tona dhe fëmijët nuk kanë ide se si kemi kaluar në ato llogore sepse nuk iu kemi treguar. Këtë për një herë tjetër. Thuaja 30 vjet pasi jemi liruar nga llogoret e ish-Jugosllavisë, ndonëse në kushte pakrahasimisht më të mira, përsëri në rastin konkret unë po përballim

me fenomenin e mosbesimit, thuaja në shkallën 80 për qind të mungesës së besimit në premtimet elektorale të të gjitha, pa asnjë përjashtim, të subjekteve garuese për zgjedhjet e 6 tetorit. Mua më duket, sa i papranueshëm aq edhe neveritës fakti se 2-3 ditë para zgjedhjeve, në përpjekje për ta diskredituar kundërshtarin për një grusht votash të pista, po gërryhet në zorret e së kaluarës në mënyrën më të pandershme dhe më të paskrupull të mundshme. Tash po dalin disa "fakte" se kryeministrja e Kosovës, znj. Vjosa Osmani, paska punuar përkthyes në UNMIK duke e implikuar, pa asnjë dëshmi, si kontribuuese e Tribunalit të Hagës, kundër luftëtarëve të UÇK-së. Apo tash po bëhet publike "afëra korruptive" e vëllait të kryetarit të Vushtrisë gjithnjë në kontekst se ka i fundit qenka mik i kryeministres Osmani. Nga përvoja ime e gjatë e që i kam përjetuar të gjitha regjimet, e them me përgjegjësi se përkthyesit që iu është besuar përkthimi nga ana e UNMIK-ut dhe Tribunali i Hagës nuk kanë qenë nga Kosova, por nga Shqipëria (Lul Basha, Argita dhe Jamarbër Maltezi dhe zonja Vokshi) dhe ca të tjerë. Përkthyesve nga Kosova nuk iu është besuar asnjë rast i ndjeshmërisë së lartë. Kush ta ka pyetur Vjosën në atë kohë? Një mik imi i mençur dhe i ndershëm më ftoi për kafe dhe duke ditur për raportet e mia të mëhershme me kryeministrin Albin Kurti kërkoi nga unë sqarime nëse gruaja e Albinit është "shkinë" dhe arsyet pse Zaim Kurti dhe Arife Kurti, ndryshe prindër të Albinit si dhe vëllezërit e paskan përzënë Albinit nga shtëpia. Thash se çështja e gruas së Albinit është krejtësisht personale dhe private andaj nuk e komentoj, ndërsa pohova se prindërit e Albinit janë të mrekullueshëm; Zaim Kurti për aq kohë sa e njoh asnjëherë nuk i është ndarë çështjes kombëtare sikur që nëna e Albinit, si të gjitha nënat shqiptare, është e mrekullueshme dhe e papërshtueshme. Edhe vëllezërit e Albinit janë intelektualë të vërtetë dhe njerëz shumë të mirë dhe me aq e mbylla. Tash po dalin informata se kryeministri i Kosovës, Kadri Veseli, qenka përfutur i luftës dhe mashtroes sepse qenka ushtar i Rognerit, në ndërkohë që tërë kohën ishte në vijat e para të frontit të luftës së lavdishme Ushtri Çlirimtare e Kosovës. Këto "informata" dalin nga zorret e zgjatura të ish-tititëve dhe ish-slobistëve apo rrahmanistëve dhe të atyre që me çdo kusht e sabotuan luftën duke bërë parada në Shqipëri me uniforma ushtarake. Edhe kryeministri i Kosovës, z. Ramush Haradinaj që, në fakt, ka qenë tmerri vetë për ushtarët, paramilitarët dhe policët e Serbisë duke bërë sakrificë personale dhe familjare dhe duke u lënë i vetmuar, me nja 20-25 ushtarë, nga dezertorët e një "ushtrie" imagjinare, po sulmohet

nga demokratët "e sotëm e që dikur ishin gjakpirësit e popullit shqiptar. Po me këto pallavra po luftohet edhe kryeministri i Kosovës, z. Fatmir Limaj. Kryeministri i Kosovës, z. Milaim Zeka, nuk po merret seriozisht, as në përfolje për faktin se po llogaritet autsajder 100 për qind. Kryeministri i Kosovës, z. Nenad Rashedi, po luftohet nga çetnikët e Aleksandër Vuçiqit dhe Goran Rakiqit kurse nuk po mbrohet as nga shqiptarët e as nga ndërkom-bëtarët. Pastaj, deri ku ka shkuar çoroditja e trillimeve kundër personaliteteve të shquara flet fakti se edhe Behgjet Pacolli, i njohur si një ndër shqiptarët më të mëdhenj të gjitha kohëve, që nga koha e Mbretëreshës Teutë e deri te Hashim Thaçi, i njohur për sakrificat sublime që i ka bërë në mbrojtje të shqiptarisë, nga Irani e deri te Kazakistani, pjesa më e ndritur, më përfaqësuese dhe më efektive e institucioneve të Kosovës, brutalisht po sulmohet nga thashethemet përmes një fotoje të montuar me një kriminel serb, në Budva të Malit të Zi. Aty pati marrë në thua edhe Shpendi. Për aq sa kam informata, Behgjet Pacolli kurrë nuk ka qenë në Budva dhe si një trashëgimtar gjenetik i Gjergj Kastriotit - Skënderbeut e që është vërtetuar shkencërisht, kurrë nuk do të takohej me kriminelë dhe armiq të kombit. E kaluara e Behgjet Pacollit është 100 për qind e pastër, në çdo aspekt, andaj protestoj publikisht për këto përfolje. Po të ishte kështu siç paraqitet se është mik me kriminelët serbë, Behgjet Pacolli kurrë nuk do ta fitonte besimin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës që e zgjedhën president dhe me të drejtë e eliminuan një njeri të vogël si puna e Adem Demaçit. Po të ishte Begja i tillë siç po mundohen ta diskreditojnë, kurrë nuk do të ishte Hashim Thaçi nuk do ta bënte mik dhe pobratim. Prandaj, votues të nderuar, mos u besoni këtyre mashtrimeve të çastit apo të aksham pazarit 2-3 ditë para zgjedhjeve. Votoni sipas bindjes suaj. Në mesin e listave për deputetë ka njerëz të mirë, njerëz të ndershëm, njerëz të moralshëm, atdhetarë që u sakrifkuan dhe u burgosën për të drejtat tuaja dhe për këtë lirë, qoftë edhe jo të plotë. Bëjeni një ndarje nga ata që luftuan dhe i dhanë çdo gjë këtij populli dhe këtij vendi dhe se për këtë nuk kërkuan asgjë. Ata që luftuan dikur, përsëri do të bëjnë sakrificë, nëse e do nevoja. Në listat për deputetë ka edhe anëtarë të partive që e kundërshtuan luftën, por që me shembullin personal e kundërshtuan Serbinë dhe dolën në anën e popullit. Mos votoni për përfutur të luftës apo të paqes që po ua marrin bukën nga sofa dhe ardhmërinë e fëmijëve tuaj. Mos votoni për ata që, me gërhërë në duar duan ta "korrigojnë" territorin e Kosovës. Mos votoni për bijtë dhe bijat e atyre që na arrestuan, na dënuan, na vranë, na trad-

htuan e që këtë përsëri do ta bëjnë, tash në emër të demokracisë. Kur të votoni duhet ta keni parasysh se Kosova po hynë në probleme të mëdha që, pa dëshirën tonë, kërkon që, ndoshta, përsëri të sakrifkohemi e këtë kurrë nuk do ta bëjnë ata që e përqeshën dhe e përqeshin sakrificën që e bëmë për këtë copë lirie dhe pavarësie! Kur të votoni, mos i merrni për bazë "informatat" e këtyre 2-3 ditëve të fundit, por analizoni kohën para, gjatë dhe pas luftës. Në bazë të asaj edhe votoni. Duhet ta keni parasysh që Kosova, pa vullnetin e saj dhe në saje të lakmive të disa "liderëve", pashmangshëm po hyn në probleme të mëdha. Votoni për të sotmen, kujtojeni të kaluarën për ta ndërtuar një të ardhme!

Parashikimi i rezultateve: Të gjithë po thonë se është vështirë të parashikohen rezultatet e zgjedhjeve të 6 tetorit. Më kujtohet se 2 apo 3 muaj para se të liroheshim nga llogoret e ish-Jugosllavisë, Baca Adem Demaçi na mblodhi të gjithëve për të dhënë një mendim për kohën që e kaluam në burg dhe të ardhmen. Shumica tregonin për plane për të ardhmen me një përcaktim të qartë se do ta vazhdojnë aktivitetin politik dhe kombëtar, pa marrë parasysh pasojat e mundshme. Fehmi Lladrovci ishte i prerë: "Dua që të dalë sa më shpejt nga burgu e t'ia kthej pushkën shkaut...". Unë, si në hajgare i thashë: "Fehmi, ju drenicasit në çdo 50 vjet e bëni një vepër të madhe kombëtare dhe, pasi t'ju qesin në këngë, pushoni 50 vjetët e ardhshëm. Ende nuk janë bërë 50 vjet nga rënia heroike e Tahir dhe Nebih Mehës". Mirëpo, Fehmi Lladrovci, bashkë me Xhevën, nuk i kishin vetëm fjalë, e kishin përnjëmend, si ushtarë të Adem Jasharit dhe Adem Demaçit. Kur më erdhi radha të deklarohem, pas më shumë se 5 vjet të kaluara në vetmi dhe izolim, thashë se do të jem shumë i lumtur nëse nga burgu dal gjysmënormal. Ashtu edhe ndodhi. Nga ajo kohë, në shumë shkrime kam deklaruar se jam i papërgjegjshëm para ligjit, para Zotit dhe para robit. Andaj po parashikoj edhe rezultatet e zgjedhjeve të 6 tetorit 2019, pa u përballur me pasojat e mundshme. I kam dy mundësi për parashikim të rezultateve:

1. Nëse në zgjedhje dalin afërsisht 35 për qind të votuesve apo rreth kësaj shifre fituese do të jetë PDK-ja. Pastaj vijnë LDK-ja, IV-ja, AAK-PSD dhe Nisma-AKR-PD. Këtyre të fundit po ua kaloj prapën për hatër të Hashim Thaçit dhe për shkak të veprës madhështore kombëtare të një shqiptari, e që nuk ka tjetër të tillë, Behgjet Pacolli.
2. Nëse në zgjedhje dalin më shumë se 42 për qind të votuesve, fituese do të dalë IV-ja ose LDK-ja, kurse e treta PDK-ja. Pastaj vijnë AAK-PSD dhe kooperativa kombëtare e udhëhequr nga Behgjet Pacolli.

Arsyetim: Sa më i madh të jetë numri i votuesve, fitorja e LV-ja është më e mundshme sikur edhe e LDK-së. Sa më pak votues, PDK-ja fiton vendin e parë. Nëse keni parasysh faktin se qytetet e mëdha janë hambarë të vërtetë të votave, atëherë LV-ja ka shumë vota në Prishtinë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Gjakovë. Nëse kësaj i shtohet edhe numri i votuesve nga diaspora, e që duket të jetë më i madh se herën e kaluar dhe fakti që këta votojnë për LV-në, kësaj partie i shtohen gjasat për fitore. Situata e paqartë e cila nuk do të qartësohet as pas 6 tetorit kur Kosova mund ta vazhdojë krizën institucionale, pa përrjashtuar mundësinë edhe për zgjedhje të tjera nëse nuk bëhen lëshime gjatë ndërtimit të koalicionëve.

Po cilat janë koalicionet e mundshme: Për ta krijuar një komoditet në vendimmarrje duhen së paku 61 vota shqiptare e që, edhe nëse bëjnë koalicion LV dhe LDK, nuk do të kenë aq deputetë. Po të bënin koalicion parazgjedhor, do të kishim një situatë tjetër. Më së shumti po flitet për koalicionin LDK - LV, kurse të tjerët në opozitë. Nëse flasim për moral real dhe jo elektoral, LV-ja dhe LDK-ja nuk do të bënin koalicion as me PDK-në, as me AAK-PSD (sidomos) e as me Facollin. Bashkësia ndërkombëtare ka rezerva për LV-në për bisedime dhe nuk do ta lejonte mbetjen në opozitë të komplet krahut të luftës. Prandaj, e them se koalicionet paszgjedhore do t'i bëjnë ambasadorët e shteteve të huaja në Kosovë e jo Vjosa Osmani apo Albini, me vija të kuqe apo ngjyra të tjera. Në rastin më të keq, këto koalicione do t'i bënte Richard Grenell, i dërguar për negociata Serbi - Kosovë. Jam i sigurt se do të shkohet në një koalicion të gjerë sepse, në këtë mënyrë më lehtë do të shpërndahet përgjegjësia për pasojat e rezultateve të bisedimeve e që nuk do të jenë edhe aq të lehta. Nisma e Facollit do të bëjë koalicion me të gjithë, kurse AAK-PSD mendon se do të jetë përcaktuese për formim të qeverisë, prandaj i ka pozicionet e forta negociuese. PDK-në po e refuzojnë të gjithë, por se vështirë do të mbetet në opozitë. Lehtë mund të ndodhë që partia që i fiton zgjedhjet mos ta ketë kryeministrin nga radhët e veta për shkak të arkitekturës së koalicionëve. Prandaj, një këshillë për subjektet politike garuese: mos u shani dhe mos u fyeni sepse nuk do ta vendosni aspak për koalicione. Në fund të fundit, të gjitha partitë, në këto çaste kur do të merren vendime jo të lehta për Kosovën, duhet të bashkohen, ose nëse duhet të pranohet diçka që imponohet ose të kundërshtohet me të gjitha mjetet e mundshme. Një gjë duhet të bëhet e qartë: Nuk duhet të negociohet as edhe 1 milimetër i territorit të Kosovës. Çdokush që e bën këtë e ka të garantuar vendin në Alejen e të Mëdhenjve në Beograd apo, nëse është vetëm një person, do të jetë afër varrit të Esat Pashë Toptanit.

Hapet çerdhja "Ketrushët" në lagjen Tophane të Prishtinës

Prishtinë, 4 tetor (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se të premten në lagjen Tophane është hapur çerdhja e re "Ketrushët". Ai ka treguar se kjo çerdhe ka kapacitet për 80 fëmijë. Sipas Ahmetit, investimi më i madh që e bëjmë si shoqëri është pikërisht investimi në edukimin e hershëm në mënyrë që fëmijëve tanë t'u sigurojmë një të ardhme më të mirë. "Sot e hapëm çerdhen e re 'Ketrushët', me bazë në komunitet, për 80 fëmijë të lagjes Tophane në Prishtinë. Investojmë në edukimin e hershëm të fëmijëve tanë, që të kemi fëmijë të lumtur dhe shoqëri të shëndoshë

në të ardhmen! Kjo është çerdhja e 15 në kryeqytet dhe shumë shpejt do të i hapim edhe çerdhet e radhës në lagjen Kalabri dhe çerdhen e rindërtuar 'Yllkat', duke vazhduar kështu derisa të arrijmë që të ofrojmë hapësirë për të gjithë fëmijët e kryeqytetit", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se sikur edhe çerdhet e tjera me bazë në komunitet, edhe kjo do të udhëhiqet nga vetë komuniteti i prindërve. "Qëllimi ynë kryesor është çerdhja me kosto të përbalueshme për të gjithë prindërit, veçanërisht për nënat vetushqyese, në mënyrë që t'ua ofrojmë mundësitë e barabarta



për edukimin e fëmijëve të tyre. Sikur edhe çerdhet e tjera me bazë në komunitet, edhe kjo do të udhëhiqet nga vetë komuniteti i

prindërve. Bashkë krijojmë mundësi më të mëdha për të ardhmen e fëmijëve të Prishtinës", ka shkruar Ahmeti.

Përurohet shkolla e re 'Afrim Krasniqi' në fshatin Bardh

MALISHEVË, 4 TETOR (ER) - Me intonimin e himnit kombëtar dhe atij shtetëror ka filluar programi festiv për përurojmë të shkollës së re "Afrim Krasniqi" në fshatin Bardh. Në këtë ditë festive dhe përurore morën pjesë shumë personalitete si nga niveli komunal, po ashtu edhe nga ai shtetëror: kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, të cilin shoqëronin, nënkryetari Hajdin Berisha dhe drejtori i drejtorive si dhe zëvendësministrat në detyrë, Rexhep Mazreku e Vesel Krasniqi, ish-deputeti Enver Hoti, Shukrije Bytyçi dhe tani kandidat për deputet, shumë prindër, nxënës dhe mësimd-



hënës. "Vetë emri i kësaj shkolle që po e përurojmë sot së bashku flet shumë sepse ka emrin e dëshmorit të kombit 'Afrim Krasniqi'. Kjo na obligon

që ta përmbushim amanetin e tyre për krijimin e kushteve sa më të mira për nxënësit dhe mësimdhënësit dhe vetëm kështu ne realizojmë dhe i

japim kuptim, atdheut, shollës dhe lirisë. Pavarësisht prej disa kritikuesve se në Malishevë po ndërtohen shumë shkolla, ne do të vazhdojmë t'u krijojmë infrastrukturë të mjaftueshme shkollore nxënësve dhe mësimdhënësve tanë për t'i arritur nivelet e nxënies me nxënësit evropianë", ka thënë kryetari Begaj. Ndërsa drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi, ka theksuar se Komuna e Malishevës prin në nivel vendi për infrastrukturën shkollore dhe, sipas tij, shumë shpejt pritet që mësimi të mbahet në 26 shkolla vetëm me një ndërrim.

30 bujq ferizajas përfitojnë mekanizëm bujqësor



FERIZAJ, 4 TETOR (ER) - Komuna e Ferizajt ka bërë me dije se ka bërë shpërndarjen e 30 mekanizmave bujqësore për bujqit ferizajas.

"Mbjellëse gruri, mbjellëse të misrit, kosa roto dhe freza ishin pajisjet që u shpërndan për bujqit ferizajas. Këta të fundit, të gëzuar për

këto pajisje dhe falënderues ndaj pushtetit lokal, thanë se Komuna e Ferizajt, përkatësisht Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyltarisë për gati

dy vjet qeverisje ka ndihmuar, si asnjëherë më parë, bujqit dhe fermerët ferizajas", ka njoftuar Komuna e Ferizajt, e cila drejtohet nga Agim Aliu. Sipas këtij njoftimi, drejtori i Bujqësisë dhe Pyltarisë, Burim Bajrami, ka thënë se kjo iniciativë dhe gjithë mbështetja për bujqit dhe fermerët ferizajas është pjesë e masës aktive të ndërmarrë nga qeverisja lokale me qëllim rritjen dhe zhvillimin e këtij sektori dhe ndikimit të drejtpërdrejtë në ekonominë familjare, rrjedhimisht në mirëqenien e përgjithshme qytetare. Kontingjente të tjera të pajisjeve bujqësore e forma mbështetjeje për bujqit do të vijojnë të aplikohen me ritëm edhe më të lartë në ditët dhe javët në vijim.

Shënohet Dita e Patates në Debelldeh të Vitisë

VITI, 4 TETOR (ER) - Në fshatin Debelldeh të Vitisë është shënuar Dita e Patates, e cila është organizuar nga Drejtoria për Bujqësi, Pyltari dhe Zhvillim Rural (DBZHR) e kësaj komune në bashkëpunim me organizatën IKC dhe organizatat e tjera. Në këtë organizim, përpos përfaqësuesve të IKC-së, kultivuesve të patates nga ky fshat ishte edhe Arton Elezi, ushtrues detyre i DBZHR-së në

Viti. Elezi ka theksuar se përmes kësaj dite synohet të promovohen kultivuesit e patates të kësaj komune, në veçanti të fshatit Debelldeh. Ai ka thënë se patatet e këtij fshati janë mjaft të kërkuara në tregun vendor. Më tutje, Elezi ka bërë me dije se ky ishte viti i dytë ku Komuna e Vitisë, në bashkëpunim me të tjerët, ka organizuar shënimin e Ditës së Patates.



E jashtëzakonshme

Instrumenti 2000-vjeçar kinez mat saktë tërmetet

Në vitin 132 të erës sonë Zhang Heng, një studiues nga Kina, paraqiti para oborrit të mbretit Han sizmoskopin e parë në botë. Madje rindërtimet që i janë bërë sot kësaj pajisjeje i masin tërmetet me saktësi të lartë. Instrumenti përbëhet nga një vazo metalike, brenda së cilës është varur një hekur me peshë, në formë lavjerrësi. Ky hekur është i lidhur me tetë gdhendje kokash dragoi që



janë vendosur rrotull, pra në tetë drejtime të ndryshme.

FOTO E DITES



Automjete të vogla dhe kamionë shihen të përmbytur nga shirat në Gangneung. /AFP/

E rrallë

Del në shitje ishulli evropian në një prej brigjeve më të bukura në botë

Gjiri Morbihan është quajtur si një nga më të bukurit në botë. Një ishull që gjendet në këtë gj, në brigjet e Bretanjes, në Francë, ka dalë në shitje për rreth 3.5 milionë euro. Ishulli, që dikur përdorej për të kapur midhje, ka një shtëpi me katër dhoma



gjumi dhe është vetëm 5 minuta larg me varkë nga Trinite-Syr-Mer, një nga brigjet më të bukura në botë. Shtëpia është ndërtuar mbi një ndërtesë të vjetër, të bërë me gurë, nga peshkatarët e midhjeve që në vitin 1870.

BARSOLETA E DITËS



Mysafiri hyn në restorant dhe pyet kamerierin:
 - O kamerier, a ka ujë?
 Kamerieri ia kthen:
 - Po zotëri, sa të duash!
 Mysafiri ia kthen:
 - Ma sill një peshqir, se po hy po lahem.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Çdo ditë në ora 16:00
Toy Story 4 / 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi;
1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

Regjia: Josh Cooley



Në ora 18:00 dhe 20:00

AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

Rolet: Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray




Çdo ditë në ora 22:00

DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

Rolet: Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

Regjia: Michael Engler



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Gjërat që kishit qëllim ka shumë gjasa që t'i keni në dorë sot.



DEMI

Do të ndiheni komod gjatë ditës së sotme. Ditën do ta merrni me qetësi.



BINJAKËT

Gjendja juaj psikologjike do të varet nga aktiviteti fizik.



GAFORRJA

Duhet ta keni prioritet krijimin e një vendi harmonik, paqeje dhe sigurie.



LUANI

Të lindurit e kësaj shenje duhet të përpqen t'i korrigojnë gabimet dhe ta largoni konfuzionin në jetën tuaj personale.



VI R G J Ë R E S H A

Do të keni dëshirë të provoni sa më shumë aventura.



PESHORJA

Tregohuni bashkëpunues, pasi puna që mund të realizoni sot, do të jetë mjaft e dobishme.
AKREPI



DIKUSH

Dikush mund t'ju komunikojë diçka të rëndësishme në punë që do t'ju vlejë pafund në ditët në vijim.



SHIGJETARI

Të lindurit e kësaj shenje do të kenë fat në marrëdhëniet e tyre personale.



BRICJAPI

Përpqini të relaksoheni dhe t'i kryeni aktivitetet që ju pëlqejnë më shumë.



UJORI

Sensi juaj i humorit do të ndihmojë dikë pranë jush të ndihet më mirë.



PESHQIT

Përvoja juaj do të bëjë që të ndihmoni një mikun tuaj të zgjidhë një situatë mjaft të vështirë.

Miley Cyrus kapet duke u puthur me mikun e ngushtë



Miley Cyrus po afrohet me shokun e vet të ngushtë Cody Simpson. Vetëm dy javë pasi u nda me Kaitlynn Carter, këngëtarja 26-vjeçare është parë duke u puthur me 22-vjeçarin, ka thënë një burim për "E! News". Sipas raportimeve, Miley dhe Cody u panë


bashkë në një dyqan ushqimesh në Los Angeles për të blerë disa gjëra ku edhe ndanë një puthje të shpejtë. Pasi të dy vunë re se njerëzit i panë, Miley dhe Cody u larguan në shpejtësi. Miley dhe Cody kanë qenë miq të ngushtë në vitet e fundit dhe janë parë shpesh bashkë.

Kylie mohon takimin me Tyga



Kylie Jenneri ka sqaruar thashethemet e fundit se ajo u ribashkua me ish të dashurin e saj Tyga mes lajmeve se ajo dhe Travis Scott janë ndarë. "Interneti bën që gjithçka të duket 100 herë më dramatike sesa është në të vërtetë. Nuk kishte asnjë takim në 2:00 të natës me Tyga. Më

shihni mua duke dërguar dy shoqet e mia në një studio ku ai ishte rastësisht", ka shkruar Kylie në llogarinë e saj në "Twitter". "Travis dhe unë jemi në marrëdhënie të shkëlqyera dhe fokusi unë kryesor tani është Stormi. Miqësia dhe vajza jonë kanë përparësi", ka shkruar ajo.



Aktorja 51-vjeçare që vazhdon të mbetet një 'Pretty Woman'

Julia Roberts vërteton çdo ditë e më shumë se bukuria nuk njih moshë. Ajo është një nga aktoret më të njohura në Hollywood. Linjat e saj trupore e tregojnë atë një femër të bukur dhe shumë seksi. Edhe pse 51 vjeçe, ajo vazhdon të mbetet një 'Pretty Woman'. Në daljen e saj të

fundit në lidhje me një fushatë për markën italiane të modës, Calzedonia sigurisht se tërhoqi vëmendjen e të gjithëve. Me këmbë të tonifikuara dhe me një fustan ngjyrë pastel te shkurtër ajo na tregoi edhe një herë që mosha është thjesht një shifër.

Ndryshimi drastik i Bebe Rexhës ndër vite



Në fillimet e saj, këngëtarja Bebe Rexha i kishte flokët e zeza dhe ishte shumë më e dobët se tani. Edhe pse nuk ishte e famshme, ajo kishte një paraqitje tërheqëse. Koha është treguar shumë

bujare me të në çdo ndryshim. Edhe pse me më shumë kile, tani ajo duket se ndihet mirë, ndaj shpesh në postimet e veta na tregon që nuk ka aspak komplekse dhe se e shijon çdo ndryshim të vetin.

Adam Smith: Asnjë shoqëri nuk lulëzon, kur shumica e popullit është e varfër



Adam Smith-i hodhi idenë e ekonomisë së lirë të ndarë nga politika, me një fjalë ai hodhi idenë kozmopolite. Ai e kundërshtonte idenë e Merkantilizmit dhe mendonte se as argjendi e as ari nuk shërbejnë në rritjen ekonomike të shtetit.

Idea e A. Smith-it për taksat ishte që ato duhet të jenë proporcionale.

Adam Smith mendonte se politika duhet të ndërhynte në ekonomi me dy qëllime kryesore: Të siguronte të ardhura të

konsiderueshme për mirëmbajtjen e qytetarëve ose më saktë ti bënte më kompetentë, për të bërë veten më të aftë për ti ofruar vetes si të ardhura ashtu dhe mirëmbajtje të jetesës. Si dhe të ofronte mundësi që në një shtet ose në një bashkësi të kishte të ardhura të mjaftueshme për shërbimet publike.

Smith ishte një ithtar i një strukture institucionale pluraliste dhe përkrah ato vlera shoqërore që tejkalojnë motivin e fitimit si në parim ashtu dhe në praktikë.

Kuptohet se vetëdija morale e

Smith-it dallohet nga prirja e tij e fortë për të trajtuar njerëzit kudo si të barabartë.

Vlen të përmendet lehtësia me të cilën Smith kapërcen pengesat, të klasës, të gjinisë, racës, dhe kombësisë, duke supozuar që të gjithë njerëzit të kenë mundësi të barabarta pa dallimin nga talentin dhe aftësitë e lindura.

Smith argumenton se dallimet klasore pasqyrojnë pabarazinë e mundësive, më shumë se talentet ose aftësitë gjenetike të lindura.

Një nga karakteristikat më të goditura të personalitetit të

Smithit është tendenca e tij të jetë aq përfshirës sa të jetë e mundur, jo vetëm në nivel lokal, por edhe globalisht.

Smith pranon hipotezën e barazisë së talentit natyral jo vetëm brenda kombeve, por edhe përtej kufijve të kombeve dhe kulturave, kjo duket qartë nga ajo që ai shkruan në të dy vepra venë Teoria e Ndjenjave Morale dhe Pasuria e Kombeve.

Pretendimi se njerëzit të cilët i përkasin fiseve të caktuara ose vijnë nga zona të caktuara ishin pikëpamje mbizotëruese inferiore për të, mungon plotësisht tek veprat e Smithit.

Pasuria e Kombeve është vepra e Smith-it, e cila mund të konsiderohet si një nga shtyllat e mendimit politiko-ekonomik.

Me këtë vepër Smithi u përpoq të ravigëzojë një tablo të marrëdhënieve politiko-ekonomike dhe të analizojë se si zhvillohet ekonomia pa ndikimin e shtetit. Kësisoj ai e pasuroi me pikëpamje të reja traditën e mendimit etik dhe traditën e së drejtës natyrore. Smithi sheh një marrëdhënie dallimi midis interesit të individit dhe të interesit të shoqërisë. Përshkrimi që ai u bën mekanizmave të tregut është me vlerë edhe sot.

Vizioni i Smith-t është jashtëzakonisht aktual. Universaliteti i ideve është

pothuajse befasues, për më tepër që ky vizion universal vjen nga dikush i cili ka jetuar 250 vjet më parë.

Disa nga aforizmat më brilante të ekonomistit të shquar janë:

– Paratë janë çështje besimi.

– Prirja për shkëmbimin e një gjëje për një tjetër është e zakonshme për të gjithë njerëzit dhe nuk gjendet në asnjë racë tjetër të kafshëve.

– Asnjë shoqëri nuk mund të lulëzojë, kur pjesa më e madhe e popullit është e varfër.

– Shkenca është ilaç për helmin e entuziazmit dhe supersticionit.

– Njeriu është një kafshë që bën pazar.

– Të gjitha për vete, asgjë për të tjerët, duket se ka qenë në çdo epokë, parimi i ndyrë e zotërinjve të njerëzimit.

– Çfarë mund të kërkojë më tepër për të qenë i lumtur njeriu që është mire me shëndet, nuk ka borxhe dhe ka ndërgjegje të pastër.

– Virtyti është më shumë për t'u frikësuar se vesi, sepse tejkalimet e tij nuk i nënshtrohen rregullimit të ndërgjegjes.

– Ankesa më e shpeshtë është ajo për mungesën e parave.

– Humaniteti është virtyti i një gruaje, bujaria e një burri.

– Çmimi i vërtetë i gjithçkaje, është mundësia dhe vështirësia e fitimit të saj.

/KultPlus

Michelle Obama: 'Gjej dhe rri me njerëz që të bëjnë të ndihesh mirë'

Michelle Obama nuk është vetëm bashkëshortja e ish-presidentit amerikan Barack Obama. Ajo është një avokate shumë e suksesshme, por njëkohësisht edhe një oratore mjaft e mirë, cilësi e cila është vënë re edhe gjatë fjalimeve politike të zgjedhjeve të fundit presidenciale në Amerikë.

Kaq e vërtetë është kjo, saqë në komentet e fjalimeve të saj në YouTube mund të lexoni shpesh edhe fjali të tipit: "Nëse ti do të garoje për presidente, vota ime do të shkonte për ty".

Ndërkohë, në këtë material ne duam t'ju sjellim disa prej thënieve të saj më të mira që kanë për t'ju mbetur gjatë në mendje për shkak të "peshës" që kanë.

"Suksesi nuk ka të bëjë aspak me sasinë e lekëve që fiton, por me ndryshimin që ti bën



në jetën e të tjerëve".

"Ti duhet të shkosh në shkollë. Ti duhet të diplomohesh në kolegji. Ti duhet të diplomohesh me patjetër, sepse nëse ka diçka që njerëzit nuk mund ta marrin dot prej teje, ai është edukimi

yt. Më beso që ia vlen çdo investim për edukimin tënd".

"Le ta pranojmë tashmë. Meshkujt e fortë, ata që ia vlenë t'i kesh idhuj, nuk e ulin një femër për t'u ndjerë vetë të pushtetshëm. Njerëzit që janë



vërtetë të fortë, i ndihmojnë të tjerët të rriten bashkë me ta".

"Nuk ke pse ndryshon për të qenë e rëndësishme. Ti je e rëndësishme ashtu siç je, pa ndryshuar gjë nga vetja".

"Gjej dhe rri me njerëz që të

bëjnë të ndihesh mirë".

"Unë nuk i loja orët e mësimin. Më pëlqente shumë të merrja nota maksimale. Më pëlqente të isha e zgjuar. Mendoj se të jesh e zgjuar është gjëra më e bukur në botë". /KultPlus

Rihapja e 'Muzeut Solomoni' në Berat bën jehonë në mediat izraelite

Mediat izraelite i kanë dhënë hapësirë rihapjes së "Muzeut Solomoni" në Berat. Është portali Israelnationnews.com i televizionit "Arutz Sheva", që ka publikuar një shkrim të Agjencisë Franceze e Lajmeve, AFP, në lidhje me rihapjen e muzeut të vetëm hebraik në Shqipëri, i cili u hap vitin e kaluar nga historiani i ndjerë Simon Vrusho. Kjo u bë falë investimit nga biznesmeni shqiptarofrancez Gazmen Toska.

Muzeu shqiptar hebre i rrezikuar shpëtoi falë 'rilindjes'

Muzeu i vetëm i historisë hebraike të Shqipërisë, "Muzeu Solomon", rihapet pasi biznesmeni e shpëton atë nga pragu i mbylljes.

Muzeu i vetëm i historisë hebraike të Shqipërisë u rihap në qytetin jugor të Beratit të dielën, falë një biznesmeni që e shpëtoi atë nga pragu i mbylljes. Muzeu i vogël "Muzeu Solomon", i cili tregon historinë se si shqiptarët strehuan qindra hebrenj gjatë Holokaustit, ishte projekti pasionant i një profesori vendas, Simon Vrusho. Vrusho e hapi muzeun në vitin 2018 dhe e financoi atë me dhurime të vogla të lëna në një kuti nga dera – dhe me pensionin e tij. Kur 75-vjeçari vdiq në shkurt të këtij viti, e ardhmja e ekspozitës u la në harresë. Pasi lexoi një shkrim të AFP (Agjencia Franceze e Lajmeve) për fatin e tij të pasigurt, biznesmeni francez-shqiptar Gazmend Toska vendosi të financojë muzeun dhe ta transferojë atë në një hapësirë më të madhe në qytet, ku shumë njerëz u mblodhën të dielën për

hapjen e tij. "Ishte thellësisht prekëse të shihej mbulimin nga ana e AFP-së të këtij muzeu," u tha Gazmend Toska të pranishmëve në këtë ceremoni. Ambasadorja e Francës në Shqipëri, Christina Vasak, e vlerësoi si "një histori të bukur e rilindjes" për muzeun që shpërblen përkushtimin e Vrushos.

Vrusho, vetë një i krishterë ortodoks, kaloi me vite të tëra duke mbledhur dokumente,

foto dhe kujtime që dëshmojnë një komunitet hebre që arriti për herë të parë në Berat në shekullin e 16-të nga Spanja. Në zemër të ekspozitës janë histori të shqiptarëve myslimanë dhe të krishterë që fshehën hebrenjtë në shtëpitë e tyre gjatë Holokaustit – një kapitull i historisë që vetëm kohët e fundit është bërë më i njohur. Falë veprimeve të tyre të heshtura të trimërisë, shteti ballkanik është i vetmi territor i okupuar nga

nazistët, popullsia hebreje e të cilit u rrit gjatë Luftës së Dytë Botërore, nga disa qindra para konfliktit në më shumë se 2000 më pas. Historia është një burim në rritje krenarie në Shqipëri, ku qeveria organizon aktivitete vjetore në Ditën e Përkujtimit të Holokaustit dhe i kushton një ekspozitë historisë në Muzeun Kombëtar të Tiranës. Por muzeu i Vrushos ishte e vetmja qendër e pavarur kushtuar spastrimit të historisë

hebraike në këtë cep të Evropës Juglindore. Ky muze është "një pemë kujtese e ujitur me dashurinë e të gjithë atyre që kanë kontribuar në mbijetesën e tij", tha e veja e Vrushos, Angelina, 65 vjeçe, e cila do të jetë drejtori i muzeut. Në këtë ceremoni, historiani Yzedim Hima tha se muzeu modest ka një mesazh të veçantë për të përcjellë: "jo mizoritë e një lufte, por dashurinë e njerëzve për njerëzit e tjerë". /Gazeta-shqip



Albania's endangered Jewish museum rescued for a 'rebirth'

Albania's sole Jewish history museum, the Solomon Museum, reopens after businessman saves it from brink of closure.



Mbretëresha Elizabeth, ditarët e saj të adoloshencës i konsideron si pasurinë e saj më të madhe



Të jesh pjesë e një prej familjeve mbretërore më të rëndësishme të të gjitha kohërave, është shumë më e vështirë nga ç'mund ta imagjinoni. Dhe kur kjo familje është familja mbretërore angleze, e cila njihet për frymën hermetike dhe rigorozë të ruajtjes së privatisë dhe respektimin të kodeve të caktuara të sjelljes, çdo lajm rreth tyre përbën bujë, sidomos kur bëhet fjalë për mbretëreshën Elizabeth.

Për shembull e keni çuar ndonjëherë në mend se cila është pasuria më e madhe e sovranes 93 vjeçare? Me siguri po mendoni për koleksionin e pafund të kurorave të ndryshme dhe bizhuterive të çmuara, të cilat arrijnë shifrën e miliona sterline. Por jo, mbretëresha nuk e ka aspak problem t'i humbasë ato, pasi pasuria e saj më e madhe janë në të vërtetë ditarët që ka shkruar që kur ishte 15 vjeç.

Sipas biografëve të familjes mbretërore, monarkja i ruan ato si sytë e ballit pasi përmbajnë jo vetëm historinë e familjes së saj, por edhe sekrete të shtetit që mund të shërbejnë edhe si armë politike nëse bien në duart e gabuara. Sipas Michael Palin, historian i njohur i familjes mbretërore vetëm princi Philipp është i vetmi që mund t'u hedhë ndonjë sy herë pas here. /living/KultPlus

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Morina: Feronikeli vjet dhe sivjet

Albutrint Morina e ka zbuluar dallimin e Feronikelit të tashëm dhe atij të vitit të kaluar kur arriti të shpallet kampion dhe ta fitojë kupën. "Ndryshimi i edicionit të kaluar me të sivjetmin është se vitin e kaluar vazhdimisht kemi pasur rezultate pozitive dhe kemi qenë më stabilë, kurse sivjet kjo vazhdimësi po na mungon. Sigurisht kanë ndikuar disa faktorë, sidomos ndeshjet e Evropës, në të cilat kemi pasur shumë ngarkesë", ka thënë Morina

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 TETOR - Kampioni në fuqi i Kosovës në futboll, Feronikeli, në mesjavë e humbi derbin ndaj Llapit (1-2) dhe me këtë rast humbi edhe pozitën e parë në renditjen tabelore të IPKO Superligës. Futbollisti Albutrint Morina ka thënë të premtën për "Epokën e re" se skuadrës nga Drenasi, në krahasim me edicionin e kaluar, është duke i munguar stabiliteti në rezultate, pasi në një ndeshje fiton me shumë gola dallim e në tjetrën pëson humbje. Sipas tij, në këtë situatë ka ndikuar edhe lodhja pas pjesëmarrjes në garat evropiane që

ishin historike për skuadrën e Feronikelit. "Si çdo humbje tjetër, edhe kjo kundër Llapit është e vështirë për t'u pranuar, por që ndodh në futboll. Llapi ka ekip shumë të fortë. Në anën tjetër, nuk ishim në ditën tonë më të mirë. Ndryshimi i edicionit të kaluar me të sivjetmin është se vitin e kaluar vazhdimisht kemi pasur rezultate pozitive dhe kemi qenë më stabilë, kurse sivjet kjo vazhdimësi po na mungon. Sigurisht kanë ndikuar disa faktorë, sidomos ndeshjet e Evropës, në të cilat kemi pasur shumë ngarkesë", ka thënë Morina. Ndeshjen e radhës skuadra e "Niklit" e zhvillon të dielën në stadiumin "Riza Lushta" kundër

Trepçës '89. Futbollisti Morina, duke folur për këtë përballje, ka bërë me dije se skuadra kampionë në çdo ndeshje shkon për fitore. "Ndeshja e radhës do të jetë shumë e vështirë kundër Trepçës '89, e cila si vendëse luan një futboll të mirë, por ne jemi kampionë aktualë dhe normalë që do të shkojmë për fitore në çdo ndeshje, përfshirë edhe këtë në Mitrovicë", ka deklaruar ai. Ndryshe nga edicioni i kaluar, hapësirat në formacionin e Feronikelit nuk po janë të mëdha për futbollistin Albutrint Morina, i cili e pranon se nuk është i kënaqur me këtë situatë. Mirëpo, ai zotohet se do të punojë edhe më shumë që të rikthehet në formacionin e tra-



skuadrat e para në tabelën e klasifikimit.

Batatina: Dua mbështetje të jashtëzakonshme ndaj Ferizajt

Llapi i Tahir Batatinës sot (e shtunë) e zhvillon përballjen e radhës në IPKO Superligë ndaj Ferizajt. Për këtë ndeshje trajneri llapjan ka kërkuar përkrahje maksimale nga tifozët "Legjendat" dhe qytetarët e Podujevës. "Dua mbështetje maksimale nga 'Legjendat' dhe qytetarët e Llapit e të Gollakut. Ne luftojmë në fushë dhe jemi të vendosur t'ju bëjmë krenarë, ndërsa ju duhet të na mbështetni në tribuna pasi që edhe në tribuna dua të jemi qyteti i futbollit. Këtë e kemi dëshmuar me vite, andaj të shtunën dua spektakël në tribuna, sepse jemi të vendosur t'ju bëjmë krenarë. E meriton qyteti i Llapit", ka shkruar Batatina në profilin e vet në "Facebook".

jnerit Dejan Vukiqeviq. "Për dallim nga edicioni i kaluar, në këtë edicion hapësirat kanë qenë më të pakta. Normalisht se është e vështirë për një futbollist kur nuk luan, por duhet të punojë ende më shumë që të kem më shumë hapësirë", ka përfunduar Morina. Aktualisht skuadra e Feronikelit zë vendin e katërt me 15 pikë të grumbulluara, dy pikë më pak se tri

Nis implementimi i luftës kundër dopingut në sport

PRISHTINË, 4 TETOR - Komiteti Olimpik i Kosovës, në bashkëpunim me Organizatën e Evropës Lindore për Anti Doping (EERADO), kanë organizuar për herë të parë seminarin me temë "Sporti i pastër", i cili është mbajtur në "Hotel Swiss Diamond" në Prishtinë.



Pjesëmarrës ishin mjekë, trajnerë, sportistë të federatave, si dhe nxënës e studentë të mjekësisë. Ligjërues nga EERADO ishin drejtuesit e kësaj organizate, drejtori gjeneral Teimuraz Ukleba dhe menaxherja Tamar Svanishvili, ndërsa nga KOK-u ishte anëtari i Komisionit Mjekësor të KOK-ut, Gëzim Murseli, kurse nga Shqipëria ishte koordinatorja në Ministrinë

për Edukim dhe Sport, Violeta Shqevi. Kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, në fjalën hyrëse u kumtoi të pranishmëve lajmin se tani e tutje edhe Kosova e ka organizatën e saj për Anti-Doping. "Duam t'ju kumtojmë lajmin se në Kosovë filloi imple-

mentimi i luftës kundër dopingut në sport, respektivisht themelimi i organizatës për Anti-Doping në Kosovë, me të cilën po iu bashkohe mi 206 shteteve që e kanë këtë organizatë", ka thënë Hasani. Drejtori i EERADO-s, Teimuraz Ukleba, duke uruar Kosovën që i është bashkuar luftës kundër

dopingut, foli edhe për anëtarësimin e Kosovës në EERADO. "Me përpjekjet e KOK-ut, në krye me kryetarin Besim Hasani, janë bërë përpjekje të mëdha për t'u anëtarësuar Kosova në EERADO dhe krahas kësaj ne tanimë kemi edhe anëtarin e KOK-ut në Bordin e EERADOS", ka thënë Ukleba, duke shtuar se në Kosovë ka ekspertë të përgatitur në luftën kundër dopingut. Anëtari i Bordit të EERADOS është Avni Nuha, kryetar i komisionit mjekësor në KOK. Anëtari i këtij komisioni, Gëzim Murseli, duke vlerësuar lart organizimin e seminarit, foli për rëndësinë që ka implementimi i luftës kundër dopingut në Kosovë si dhe për anëtarësimin e

Kosovës në EERADO. I pranishëm në seminar ishte edhe Drejtori i Departamentit të Sportit në Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport, Ibër Alaj, i cili ka thënë se seminarin e tilla mundësojnë ndarjen e përvojave dhe marrjen e informatave të reja që ndodhin në zhvillimin e sportit, në këtë rast të antidopingut, që është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e "fair-play". Për substancat dhe metodat e ndaluara bazuar në listën e WADA-s foli specialisti i Mjekësisë Sportive, Bernard Tahirebegolli. Një ditë më parë u mbajt edhe trajnimi për ngritjen e kapaciteteve të Anti-Dopingut, ku pjesëmarrës ishin nxënës dhe studentë të mjekësisë.

Challandesi publikon listën e futbollistëve për ndeshjet e tetorit

PRISHTINË, 4 TETOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Bernard Challandes, ka publikuar listën e futbollistëve që do t'i ketë në dispozicion për dy ndeshjet e këtij muaji. Kosova fillimisht zhvillon miqësoren kundër Gjibraltarit më 10 tetor dhe në ndeshjen kuali-

fikuese për "Euro 2020" kundër Malit të Zi, më 14 tetor. Përgatitjet për këto dy ndeshje "Dardanët" do t'i nisin të hënën në stadiumin "Fadil Vokrri", e në të njëjtën ditë përzgjedhësi Challandes do të paraqitet në konferencë për media, në orën 11:00, në hotel "Emerald".



LISTA E FUTBOLLISTËVE

Samir Ujkani, Arjanet Muriq, Visar Bekaj, Mërgim Vojvoda, Florent Hadergjonaj, Arbenit Xhemajli, Ibrahim Dresheviq, Amir Rrahmani, Fidan Aliti, Leart Paqarada, Benjamin Kolli, Herolind Shala, Valon Berisha, Idiz Voca, Anel Rashkaj, Florent Hasani, Florent Muslija, Bersant Celina, Bernard Berisha, Elbasan Rashani, Milot Rashica, Edon Zhegrova, Lirim Kastrati, Vedat Muriq, Atdhe Nuhiu.

Rikthehet klasikja e basketbollit Peja - Prishtina

PRISHTINË, 4 TETOR - Sot (e shtunë) do të zhvillohen të gjitha ndeshjet e javës së tretë të Superligës së Kosovës në basketboll. Kjo xhiro sjell edhe super derbin në mes të Pejës dhe Sigal Prishtinës. "El Klasiko" e basketbollit rikthehet pas një viti mungesë, derisa atmosfera në

'Karagaçi' pritet të jetë fantastike, me tifozët pejanë që gjithmonë e kanë përkrahur skuadrën e tyre dhe do të dëshmojnë se sa u ka munguar klubi në Superligë. Prishtina edicionin e kaluar fitoi titullin, Kupën e Superkupën, kurse në xhiron e parë pësoi nga Rahoveci, e në mesjavë

mundi Ponte Prizrenin. Kjo e fundit do të ndeshet me Feronikelin, ndërsa ndeshje interesante konsiderohet ajo në mes të Golden Eagle Yllit dhe Trepçës. Ndeshja e fundit për këtë xhiro është në mes të Rahovecit dhe Lipjanit. Bashkimi në këtë xhiro pushon.

Superliga - Java 3

15:00 Ponte Prizreni - Feronikeli
17:00 Golden Eagle Ylli - Trepça
19:00 Peja - Sigal Prishtina
21:00 Rahoveci - Lipjani
Bashkimi (pushon)



Sot zhvillohen katër ndeshje në Superligën e hendbollit

PRISHTINË, 4 TETOR - Katër ndeshje të javës së dytë të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt) luhen sot (e shtunë). Ndeshja e parë luhet në Pejë në mes të Besa Fargas dhe Dritës së Gjilanit

nga ora 15:00. Skuadra pejane nuk pritet të ketë telashe për t'i arkëtuar dy pikë të reja. Nga ora 17:00 zhvillohet takimi Prishtina - Vëllaznimi, kurse skuadra prishtinase është favorite. Dy ndeshje të


tjera luhen nga ora 19:00 dhe pritet të ketë rivalitet më të madh. Vushtrria e pret Drenicën, kurse Llapi takohet në Podujevë me Prizrenin. Ndeshja në mes të Kastriotit dhe Trepçës luhet më 9 apo 10

tetor për shkak të ndeshjeve evropiane të Kastriotit. Në Ligën e Parë të meshkujve ndeshjet e javës së dytë janë: Samadrexha - Deçani, KEK-u - Rahoveci, Zhegra - Lepenci, Vjosa - Ulpiana.



Tierney dhe Bellerin: Xhaka, kapiten ideal për Arsenalin

Londër, 4 tetor - Kieran Tierney dhe Hector Bellerin kanë mbështetur vendimin e Unai Emery për ta emëruar Granit Xhakën kapiten të Arsenalit. Xhaka u emërua kapiten i përhershëm i klubit pas largimit të Laurent Koscielny. 27-vjeçari mori edhe mbështetjen e shokëve të skuadrës, edhe pse ka shumë zëra dhe pakënaqësi te tifozët. Xhaka deri më tani ka bërë 141 paraqitje për "Topçinjtë" që prej ardhjes nga Borussia Monchengladbach në vitin 2016 dhe Emery mendoi se zgjidhja më e mirë është 27-vjeçari. "Mendoj se ai është kapiten i shkëlqyer për klubin. Ai e njeh klubin më mirë se të tjerët dhe e di se çfarë do të thotë të luash për këtë klub. Gjithashtu, ai është lojtar që luan pothuajse çdo ndeshje. Edhe kur lëndohet, ai gjithmonë është gati për të luajtur, kështu që mendoj se është kapiten i duhur", ka thënë Bellerin. Në anën tjetër, Tierney, që iu bashkua Arsenalit nga Celticu verën e kaluar, ka shtuar: "Që kur kam ardhur ai ka qenë aty për të më ndihmuar. Duke e



parë këtë dhe ajo se çfarë jep në stërvitje dhe fushë çdo ditë, 100 % nga vetja, kjo do të tregojë çfarë lideri është".

Ismajli: Ndaj Francës isha më i miri dhe doja ta 'haja' barin

TIRANË, 4 TETOR - Ardian Ismajli është një nga lojtarët më të mirë të Kombëtares aktualisht. Erdhi si një afrim i ri dhe u mendua se do ta donte kohën e zakonshme për t'u përshtatur me grupin, por nuk ndodhi kështu. Merr menjëherë vendin e titullarit të padiskutueshëm, ndërsa arrin njëkohësisht të marrë gjithë përgjegjësinë dhe peshën e prapavijës. Gabimet e tij mund të numërohen me gishtat e dorës, duke qenë i padiskutueshëm për trajnerët e Shqipërisë, që nga Reja dhe pa harruar Panuccin. Në një rrëfim të gjatë për mediat kroate, mbrojtësi i Hajdukut të Spliti ka folur më në veçanti për atë përballje të Shqipërisë kundër Francës në transfertë. "Ishte një përvojë e madhe për mua që në vështrimin e 75 mijë tifozëve të luaja në Francë. Unë doja që ta haja barin. Nëse të gjithë do të ishin si unë, do të ishte ndryshe. Disa lojtarë u impresionuan që në nisjen e ndeshjes. E pësuam goditjen shumë shpejt dhe ishte e



vështrirë ta ktheje rezultatin. Nëse shohim statistikën, isha më i mirë në atë takim. Të mbash lojtarë si Giroud apo Griezmann është vërtet e veçantë. Trajneri Reja është i interesuar për Hajdukun, gjithmonë më pyet mua. Jo vetëm ai, por edhe Gigi Febrari. Ata më thonë se u mungon Spliti. Në çdo dimër të dy ata vijnë në Split para Krishtlindjeve. Gigi më ka thënë se e ka Splitin si shtëpi të dytë.

Kam bërë përparim më teknik në aspektin personal. Kam ardhur nga Kosova dhe atje nuk kishte shumë fusha të mira. Bari këtu është i përsosur. Në Kosovë topi kërcente. Babai im, Ilmiu, më ka dhënë motiv dhe doja të largohesha nga Kosova për të shkuar në një përvojë tjetër. Para se të vija në Hajduk doja ta provoja Prishtinën. Kam qenë për 6 muaj atje", ka thënë Ismajli.

SHKURT

Erëleta Memeti: Duam fitore ndaj Estonisë

Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave është duke i zhvilluar përgatitjet për ndeshjen e tretë në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2021" kundër Estonisë që zhvillohet më 8 tetor në Tartu. Futbollistja e Kosovës, Erëleta Memeti, ka thënë se kërkohet fitorja ndaj Estonisë për të treguar se nuk ishte i rastësishëm triumfi ndaj Turqisë. "Është mirë që tani po kemi rast të jemi më shpesh së bashku dhe të gjitha vajzat po e presim me entuziazëm ndeshjen e radhës. Fitorja në ndeshjen e parë kundër Turqisë ka qenë ndjenjë e jashtëzakonshme, por humbja me Slloveninë na e ka lanë një shije të keqe. Tani është koha që kundër Estonisë t'i tregojmë cilësitë tona dhe të dëshmojmë se fitorja kundër Turqisë nuk ishte e rastësishme. Gjatë këtyre tri ditëve kemi punuar shumë mirë në stërvitje dhe jam optimiste se nga Estonia do të kthehemi me fitore", ka thënë Memeti.

Isco - Suso mund të shkëmbehen në janar

Fantazisti spanjoll Isco ka përfunduar jashtë planeve të Zinedine Zidane dhe thau se nuk po luan fare në këtë fillim sezoni, ndërsa mediet spanjolle konfirmojnë se futbollisti është në shitje dhe se pritet të largohet që në janar. "Don Balon" zbulon se drejtuesit e Realit të Madridit kanë folur me ata të Milanit dhe u kanë ofruar një shkëmbim mes Iscos dhe Susos.

Lëndohet Marcelo

Skuadra e Real Madridit vazhdon të përcillet nga lëndimet e shumta të futbollistëve. I fundit që ka pësuar lëndim është mbrojtësi brazilian Marcelo, i cili do të mungojë në ndeshjen që Reali e zhvillon të shtunën ndaj Granadës. Sipas një njoftimi të lëshuar nga Real Madridi, thuhet se Marcelo ka shfaqur probleme në kofshën e djathtë dhe nuk do të jetë i gatshëm për skuadrën. Ky dëmtim pritet ta mbajë jashtë fushave për 10 ditë mbrojtësin 31-vjeçar.

Lowi: Neueri është numër 1, Ter Stegen mbron në miqësore

Trajneri Joachim Low ka folur për temën e shumëpërfolur në mes të dy portierëve, Manuel Neuer dhe Marc Andre Ter Stegen. Javën e fundit ka pasur shumë debat se cili portier duhet të jetë titullar te Kombëtarja e Gjermanisë. Megjithatë, trajneri i Gjermanisë, Low, ka konfirmuar se Neueri do të jetë numri 1 i kombëtares. "Së bashku me trajnerin e portierëve Andreas Kopke kemi vendosur që Marc të luajë në Dortmund dhe Manu në Tallinn. Ne e kemi diskutuar me të dy lojtarët këtë. Kam konfirmuar shumë herë se Manuel Neueri është kapiteni ynë dhe numri 1 në Kampionatin Evropian për sa kohë që nuk ndodh asgjë e jashtëzakonshme", përfundoi trajneri i Gjermanisë", ka thënë Low.

Babai i Khabibit, McGregorit: Për revansh të presim në Moskë

Mesa duket Khabib-McGregor 2 nuk është një ëndërr e përealizueshme. Babai i Khabib Nurmagedov Abdulmanap ka folur për kanalin rus "Zhivina100" për mundësinë e një përballje të dytë mes birit të tij dhe Conor McGregor në Rusi më 2020. "Nëse McGregor e do atë ndeshje, atëherë Moskë është gati për të. Ai ka thënë një herë se ka më shumë tifozë se Khabib këtu. Duam ta presim në Moskë, ai është i mirëpritur. Megjithatë, përpara ndeshjes me McGregor duhen larë hesapet me Fergusonin. Ai ka fituar 12 ndeshje radhazi në UFC ashtu si Khabib. Ajo do të jetë një supersfidë e cila nuk ka ndodhur ndonjëherë në UFC. Mendoj se ndaj Fergusonit do të ndeshemi në Madison Square Garden të Nju Jorkut, por nuk do të ndeshemi para marsit", ka deklaruar babai i Khabibit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva - Ministry
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteti i Kosovës
Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital
“Prim. Dr. DAUT MUSTAFA”
Prizren



Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, kërkesës për rekrutim nr.2/102, nr.2/183, nr. 2/255 të aprovuar nga drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së, si dhe nenit 13, pika 1.1 të Statutit të Spitalit, Këshilli Drejtues i Spitalit të Përgjithshëm shpall:

KONKURS PUBLIK

Për pranimin në marrëdhënie pune
Titulli i vendit të punës:

1. Mjek specialist – Urolog (1 vend pune)

Koeficienti i pagës: 8.4

Norma e punës: Orar i plotë

Kohëzgjatja e kontratës: Në kohë të pacaktuar me periudhë provuese 3 (tre) mujore

2. Fizioterapeut Bachelor (2 vend pune)

Koeficienti i pagës: 7.2

Norma e punës: Orar i plotë

Kohëzgjatja e kontratës: Në kohë të pacaktuar me periudhë provuese 3 (tre) mujore

3. Farmacist i diplomuar (1 vend pune)

Koeficienti i pagës: 7.2

Norma e punës: Orar i plotë

Kohëzgjatja e kontratës: Në kohë të pacaktuar me periudhë provuese 3 (tre) mujore

Numri i referencës: 8/42, data 04.10.2019

1. -Mjek specialist – urolog

Qëllimi kryesor i vendit të punës : Ofrimi i shërbimeve shëndetësore të nivelit sekondar.

Detyrat kyçe: Klinike, menaxhuese dhe profesionale

Përgjegjësitë kyçe: Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasi bazuar në nivelin profesional që ka mirësjellja, kujdesi dhe respektimi i pacientit dhe personelit punues.

Përshkrimi i punëve dhe fushat e përgjegjësisë: Bashkë me Shefin e repartit dhe stafin tjetër drejtues menaxhon me resurset humane, pajisjet, objektet e inventarin për nivelin të

realizimit e trajtimit, kryen vlerësime specifike sipas indikacioneve dhe interpreton dhe komunikon të dhënat e vlerësimeve, zhvillon planin e trajtimit sipas problemeve të identifikuar dhe përcakton qëllimet e trajtimit, Realizon trajtimin e paraparë në planin e trajtimit, Modifikon adapton trajtimin sipas indikacioneve për arritjen e qëllimeve, Jep këshilla dhe udhëzime për programin shtëpiak për mirëmbajtjen dhe rritjen e rezultateve të arritura gjatë trajtimit, Dokumenton rezultatet e vlerësimit, trajtimit, përcjelljes dhe përfundimit të trajtimit, Rekomandon marrjen dhe fabrikimin e pajisjeve ndihmëse ortoptike ose protetike si dhe këshillon pacientët, familjarët dhe personelin tjetër për përdorimin dhe aplikimin e këtyre pajisjeve, Mbikëqyrë dhe udhëheq punën e teknikëve të fizioterapisë dhe personelit tjetër ndihmës në implementimin e planit të trajtimit, Komunikon në mënyrë formale dhe joformale me profesionistët tjerë në koordinimin e programit rehabilitues të pacientit, Merr përgjegjësi për aftësimet e vazhdueshëm profesional dhe ngritje profesionale. Kryen dhe detyra tjera sipas nevojës.

Kualifikimet e nevojshme: Fakulteti i kryer Fizioterapeut Bachelor

Dokumentacioni i kërkuar:

1. Diploma e Fizioterapeut Bachelor – (origjinal apo kopje e vërtetuar)
2. Licenca e punës nga Ministria e Shëndetësisë valide (origjinal apo kopje e vërtetuar)
3. Çertifikata e lindjes (origjinal apo kopje e vërtetuar) dhe fotokopja e letërnjoftimit
4. Çertifikata që nuk jeni i dënuar ose nën hetime (origjinal apo kopje e vërtetuar)
5. Çertifikata mbi gjendjen shëndetësore (pas pranimit në marrëdhënie pune)

3. Farmacist i diplomuar

Qëllimi kryesor i vendit të punës: Ofrimi i shërbimeve të nivelit sekondar.

Detyrat kyçe: Të zbatohet të gjitha aktivitetet profesionale specifike për profesionin dhe departamentin ku punon, Të caktojë, implementojë dhe vlerësojë produktet medicinale dhe materialin mjekësor në përputhje me politikën e aprovuar, Të mbledh të dhëna të sakta mbi barnat dhe materialin mjekësor sipas kërkesave nga tekniku përgjegjës dhe farmacisti, Të kontribuojë në krijimin e një medisi të sigurt për të gjithë bashkëpunëtorët dhe kolegët, Të ofrojë infermierëve të Reparteve informata të sakta lidhur me procedurat e furnizimit dhe gjendjen e stoqeve, Të përkujdest për afatet e skadimit të medikamenteve dhe materialit sanitar, Të merret me kontrollimin e mjeteve me të cilat bëhet transporti i tyre, kontrollimin e hapsirës për ruajtjen e tyre në përputhje me udhëzuesit, Të administrojë pranimin dhe dorëzimin e mallit si dhe deponimin e atyre me afat të skaduar sipas politikave institucionale, Të administrojë me programin Sistemit për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik, Të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbarevajtjen e punëve, Të merr pjesë në aktivitetet për edukim të vazhdueshëm profesional në mënyrë që të përmbushen kriteret për vazhdim të liqencës së punës.

Detyrat specifike: Të kontrollojë afatet e skadimit të barnave dhe materialit sanitar në stoqe, Të kontrollojë dhe eventoj mungesat duke raportuar përgjegjësinë e Sektorit të Barnatores Qendrore, Barantores Klinike lidhur me barna dhe material shpenzues, Të jetë antar i komisionit për evidentimin në pranimin e mallit, Raportimi përgjegjësve të sektorit, Asistimi përgjegjësve të Barnatores Qendrore ose Barnatoreve të reparteve për kryerjen e raporteve ditore, mujore apo vjetore, Të përgatitë dhe dorëzojë mallin kryeinfermierëve

cilit i takon, Siguron standarde të larta të përkujdesjes ndaj pacienteve, Mirësjellja, kujdesi dhe respektimi i pacientit dhe personelit punues, Mirësjellja dhe bashkëpunimi profesional me stafin tjetër punues, Pranimi, ekzaminimi e trajtimi përkatës i pacientit, Kryen evidentimin e rregullt përmes dokumentacionit mjekësor (historia e sëmundjes, fletlëshimi, protokollit etj) të pacientit, Kryen vizitat e rregullta tek pacientët e shtrirë në institucionin shëndetësor, Bënë kërkesa për vizita plotësuese-konsultative, Mbikëqyrë realizimin e detyrave ditore të punës të stafit punues, Jep mendime profesionale për punën që kryen, Kryen detyra të tjera ashtu si kërkun mbikëqyrësi për mbarevajtjen e punëve në institucionin ku është i punësuar, Kryen edhe detyra të veçanta kur i kërkohen lidhur me profesionin e ngushtë specialistik që ka, Është përgjegjës për hartimin e plan-programit të punës së tij individuale e kolektive në vendin e punës, Angazhon stafin punues në realizimin e detyrave ditore të punës, Siguron dhe zhvillon programe e kurse trajnimi profesional, Bën kontrollin e rregullt (inspektimin e hapësirave, pajisjeve dhe të inventarit në vendin e punës), Siguron ambient të pastër e të sigurt për të gjithë, Menaxhon me material shpenzues dhe pajisjet tjera, Siguron sistem efikas komunikimi për të gjithë brenda institucionit, Përpunon dhe realizon protokole profesionale të trajtimit të pacienteve, Merr pjesë në studime kërkimore-shkencore profesionale, Ndërmerr masa për ngritjen e cilësive menaxhuese të aftësimin profesional dhe kolektiv në repart(njësi), Ushtron detyra plotësuese bazuar në kualifikimin e tij profesional dhe menaxhuese etj, Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor bazuar në nivelin profesional që ka, Dhënia e këshillave profesionale me shkrim e me gojë rreth trajtimit të pacientit dhe përcaktimit të terapisë ditore, Përcakton radhën dhe planin e ekzaminimeve klinike-laboratorike, Sipas radhës punon në ambulancën për pacientët jashtëspitalor dhe bëjnë ekzaminimin-pranimin e tyre, Kryen dhe detyra tjera sipas nevojës.

Kualifikimet e nevojshme për vendin e punës: Specializimi i kryer nga lëmia përkatëse

Dokumentacioni i kërkuar:

1. Diploma e fakultetit të mjekësisë – (origjinal apo kopje e vërtetuar)
2. Çertifikata mbi specializimin- (origjinal apo kopje e vërtetuar)
3. Licenca e punës nga Ministria e Shëndetësisë valide (origjinal apo kopje e vërtetuar)
4. Çertifikata e lindjes (origjinal apo kopje e vërtetuar) dhe fotokopja e letërnjoftimit
5. Çertifikata që nuk jeni i dënuar ose nën hetime (origjinal apo kopje e vërtetuar)
6. Çertifikata mbi gjendjen shëndetësore (pas pranimit në marrëdhënie pune)

2. Bachelor i fizioterapisë

Qëllimi kryesor i vendit të punës : Ofrimi i shërbimeve shëndetësore të nivelit sekondar.

Përshkrimi i punëve dhe fushat e përgjegjësisë për Fizioterapeut : Të punojë si pjesëtar/e i/ e ekipit të kujdesit mjekësorë në ofrimin e standardit me të lartë të kujdesit shëndetësor të përqendruar në pacientin, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurt për pacientët, Ofron dhe udhëheq shërbimet e fizioterapisë ndaj pacientëve, përfshirë vlerësimin, trajnimin, planifikimin dhe realizimin e trajtimit dhe mbajtjen e dokumentacionit të nevojshëm, Ofron shërbimet e fizioterapisë ndaj pacientëve, Kryen ekzaminimet e pacientëve për të caktuar nevojën për intervenim / trajtim, Vlerëson pacientin me qëllim të marrjes së informata ve të nevojshme për planifikimin dhe

të reparteve, dhe barnatoreve të reparteve, Të punojnë sipas orarit të paraparë nga menaxhmenti (me kujdestari/ndërrime), Kryen dhe detyra tjera sipas nevojës.

Kualifikimet e nevojshme për vendin e punës - Fakulteti i kryer Farmacist i diplomuar

Dokumentacioni i kërkuar:

1. Diploma e Fakultetit të Farmacisë – (origjinal apo kopje e vërtetuar)
2. Licenca e punës nga Ministria e Shëndetësisë valide (origjinal apo kopje e vërtetuar)
3. Çertifikata e lindjes (origjinal apo kopje e vërtetuar) dhe fotokopja e letërnjoftimit
4. Çertifikata që nuk jeni i dënuar ose nën hetime (origjinal apo kopje e vërtetuar)
5. Çertifikata mbi gjendjen shëndetësore (pas pranimit në marrëdhënie pune)

Kushtet për pjesëmarrje në rekrutim për të gjitha pozitat: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe i plotësojnë kushtet sipas konkursit për vendin e punës për të cilin aplikojnë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendrike nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik

Aplikacioni merrret në zyrën nr.1 të Administratës së Spitalit së bashku me përshkrimin e detyrave të punës. Aplikacioni me dokumentacion përcjellës dorëzohet në Administratë-zyra e personelit, çdo ditë pune nga ora 7:00-15:00h. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa, aplikacionet e mangëta refuzohen.

Prizren,
03.10.2019



Drejtor i Administratës
Melinda Collaku, Mr. sci. e Juridikut



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës



Univerziteti i Prizrenit
Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova - Hospital and University
Clinical Service of Kosovo

Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital
“Prim. Dr. DAUT MUSTAFA”
Prizren

Na osnovu člana 8 Zakona br. 03 / L-212 o radu, Administrativnog uputstva (MRSZ) Br. 07/2017 o regulisanju procedura javnih konkursa, prijava za zapošljavanje br.2/102, br. 2/183, br. 2/255, odobrena od strane generalnog direktora KSHKUK, kao i član 13, tačka 1.1. Statuta Bolnice, Upravni odbor Opšte bolnice objavljuje:

Javni Oglas

Za prijem u radni odnos

Naziv radnog mesta :

1. Lekar specialista – urolog (1 pozicija)

Koeficijent: 8. 4

Radni standard: Puno radno vreme

Trajanje ugovora: Neograničeno sa probnim radom od 3 (tri) meseca

2. Bachelor fizioterapeuta (2 pozicija)

Koeficijent: 7. 2

Radni standard: Puno radno vreme

Trajanje ugovora: Neograničeno sa probnim radom od 3 (tri) meseca

3. Diplomirani farmacist (1 pozicija)

Koeficijent: 7.2

Radni standard: Puno radno vreme

Trajanje ugovora: Neograničeno sa probnim radom od 3 (tri) meseca

Broj referce: 8/42, datum 04.10.2019

1. Lekar specialista – urolog

Glavna svrha radnog mesta: Pružanje usluga zdravstvene zaštite na sekundarnom nivou.

Ključni zadaci: Klinički, menadžerski i profesionalni

Ključne odgovornosti: Pružanje zdravstvenih usluga u kvalitativnom i kvantitativnom smislu na osnovu profesionalnog nivoa uljudnosti, brige i poštovanja prema pacijentu i radnom osoblju.

Opis rada i odgovorne delatnosti: Zajedno sa šefom odeljenja i ostalih nadzornog osoblja upravlja ljudskim resursima, opreme, objekata inventar za nivo na kome pripada, obezbedi visok standard nege pacijenata, ljubaznost, briga i poštovanje za pacijente i osoblje radi, ljubaznost i saradnja sa drugim osoblje koje radi profesionalno, Prijem, ispitivanje i lečenje pacijenta u pitanju, Redovno identifikaciju putem medicinske dokumentacije (istorija bolesti, otpusni list, protokol, itd) pacijenta, Izvršiti redovne posete bolničko lečenje u zdravstvenoj ustanovi, Napravljeni zahteva za dodatnim konsultativne posete, Vrši nadzor primene dnevnih radnih zadataka radne osoblja, Daje stručna mišljenja za rad koji

obavljaju, Obavlja i druge poslove u skladu sa supervizora za rad u instituciji u kojoj je zaposlen.

Neophodne kvalifikacije: Završena specijalizacija iz određene oblasti

Potrebna dokumentacija:

1. Diploma medicinskog fakulteta – (original ili overena kopija)

2. Uverenje o specijalizacija - (original ili overena kopija)

3. Validna licenca rada od Ministarstva Zdravlja (original ili overena kopija)

4. Izvod iz matricne knjige rođenih (original ili overena kopija) i fotokopija licne karte

5. Uverenje da niste osudjeni ili pod istragom (originalu ili overena kopija).

6. Uverenje o zdravstvenom stanju (posle primanja u radni odnos)

2. Bachelor fizioterapeuta

Glavna svrha radnog: Pružanje usluga zdravstvene zaštite na sekundarnom nivou.

Opis rada i odgovorne delatnosti: Pruža i vodi Fizioterapeutske usluge pacijentima, uključujući rocenivanje, lečenje, planiranje i realizaciju tretmana i vođenje neophodne dokumentacije, Pruža fizioterapeutske usluge pacijentima, Izvodi procenivanje pacijenata kako bi utvrdio potrebu za intervenciju / tretman, Procenjuje pacijenta kao bih dobio potrebne informacije za planiranje i realizaciju fizioterapeutskog tretmana, izvodi specifične procene na osnovu indikacija i interpretira i komunicira nalaze ovih procena, Razradjuje plan tretmana na osnovu identifikovanih problema, kao i određuje ciljeve lečenja, Izvodi postupke predviđene u plan lečenja, Modificira i adaptira tretman na osnovu indikacija za postizanje ciljeva, Dokumentira rezultate procene, tretmana, procenja i zavrsetka tretmana, Preporučuje uzimanje i izradu ortotickih i protetickih pomagala kao i daje savete pacijentima, porodici i drugom osoblju za upotrebu ovih pomagala, Nadgleda i vodi posao fizioterapeutskih tehnicara i drugog pomocnog osoblja u implementiranju plana tretmana, Nadgleda studente i voluntere, Komunicira na formalan i ne formalan nacin sa ostalim strucnicima oko spovodjenja rehabilitacionog programa, Preuzima odgovornost za kontinuirano profesionalno usavršavanje i unapredjenje, Raportira i odgovara glavnom fizioterapeutu Jedinice. Obavlja i druge poslove u skladu sa supervizora za rad u instituciji u kojoj je zaposlen.

Neophodne kvalifikacije: Završenu fakultet fizioterapije Bachelor

Potrebna dokumentacija:

1. Diploma fakulteta Bachelor fizioterapije – (original ili overena kopija)

2. Validna licenca rada od Ministarstva Zdravlja (original ili overena kopija)

3. Izvod iz matricne knjige rođenih (original ili overena kopija) i fotokopija licne karte

4. Uverenje da niste osudjeni ili pod istragom (originalu ili overena kopija).

5. Uverenje o zdravstvenom stanju (posle primanja u radni odnos)

3. Diplomirani farmacist

Glavna svrha radnog: Pružanje usluga zdravstvene zaštite na sekundarnom nivou.

Ključni zadaci: Sprovoditi sve profesionalne aktivnosti specifične za profesiju i odeljenje u kojoj radi, Da odredi, sprovede i proceni medicinske proizvode i medicinske materijale u skladu sa odobrenim politikama, Prikupiti tačne podatke o lijekovima i medicinskim materijalima na zahtjev odgovornog tehničara i farmaceuta, Doprinijeti stvaranju sigurne medicinske klinike za sve saradnike i kolege, Obezbediti medicinske sestre sa klinikama /

odeljenjima sa tačnim informacijama o procedurama snabdevanja i statusu zaliha, Voditi brigu o isteku lekova i sanitarnih materijala, rukovati provjerom sredstava kojim se prevoze, proveriti njihov skladišni prostor u skladu sa smjernicama, Da administruje prijem i isporuku robe, kao i deponovanje isteklih roba u skladu sa institucionalnim politikama, Da upravlja programom Farmaceutskog sistema za upravljanje zalihama, Preduzeti sve potrebne mjere za izvođenje radova, Učestvuju u aktivnostima kontinuiranog stručnog obrazovanja kako bi ispunili kriterijume za kontinuitet radne sposobnosti.

